



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit me Karakter Profesional
“ Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje ”
“Universiteti Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Fatmir MEMAJ
2. Prof. Asoc. Dr. Ira GJIKA

Tetor/ 2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në
“Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti” (UniBA)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje” (TOBMSH)
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Nr. 568, datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati nr. 15, datë 28.03.2023, miratuar me shkresë MAS Nr. 2173/I, datë 28.04.2023.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	ID: MB3425221650, lëshuar nga QSHA, dt.31.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim i Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	2 vite /4 simestra
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	n/a
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	n/a
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	n/a
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11/2 për vitin akademik 2023-2024 11/1 për vitin akademik 2022-2023
18	Numri i studentëve:	18 studentë të regjistruar 13 2023-2024 5 2022-2023
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” është një program studimi me kohë të plotë, që ofrohet nga Universiteti “Barleti”, Tiranë. Programi është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Nr. 568, datë 12.09.2018 dhe ka marrë akreditimin e parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022. Programi i studimit me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF), njësi e vendosur pranë Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) në Universitetin “Barleti”.

Universiteti “Barleti” (UniBa) është krijuar në vitin 2005 si institucion jo publik i arsimit të lartë bazuar në VKM Nr. 571, datë 12/08/2005, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike emërtuar “Universiteti Marin Barleti” dhe është riorganizuar në vitin 2020 në Universitetin “Barleti” (UniBa). Aktualisht ka në përbërje katër fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr. 80 të vitit 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”.

Universiteti “Barleti” ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e “Kartës së Bolonjës” dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të Universitetit “Barleti” të përcaktuar në Statutin e institucionit, duke ofruar programe studimi cilësore, bashkëkohore dhe aplikative.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se programi i studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” ofrohet nga UniBa në përputhje me këto prioritete. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të Universitetit “Barleti”. Ky program studimi zhvillohet në gjuhën shqipe, me kohë normale 2 vite akademike, i ndarë në 4 semestra dhe ofron 120 kredite. Në përfundim të ciklit të studimeve merret diploma me profilin përkatës.

Programi 2 vjeçar me karakter profesional ofron njohuri teorike dhe sidomos aftësi praktike në fushën e operacioneve të biznesit, marketingut dhe shitjes. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet në biznese të ndryshme si specialist i nivelit përkatës në sektorin e biznesit, marketingut dhe shitjes kryesisht në sektorin privat.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të akreditimit periodik për programin e studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” që organizohet nga UniBa.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi dy vjeçar me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”, të ofruar nga Universiteti Barleti është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL, i përbërje nga

1. Prof. Dr. Fatmir MEMAJ
2. Prof. Asoc. Dr. Ira GJIKAJ
3. Msc. Anilda BEQIRAJ, koordinatorë teknike i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm.

Në bazë të vlerësimit kanë qënë kriteret e vendosura në Ligjin nr. 80/2015, datë 22/07/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Për hartimin e raportit grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua në raportin e vlerësimit të brendshëm, dokumentat mbështetës të dorëzuara nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, si dhe në vizitën e programuar që grupi kreu në institucion, në mars 2024. GVJ mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) dhe Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF) përgjegjës për programin, me personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC) dhe njësisë të tjera në nivel institucioni.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti vlerësimi është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit profesional 2 vjeçar në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Institucioni dorëzoi dokumentat dhe evidencat e nevojshme për akreditimin në format elektronik tek ASCAL. Gjithashtu, gjatë vizitës së GVJ në institucion u paraqitën evidenca shtesë për të mbështetur aplikimin e tyre për akreditimin e programit të studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”.

Mbi këtë bazë u hartua raporti i vlerësimit të jashtëm që GVJ paraqet.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 54, datë 09.09.2022

Programi i studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022.

Për sa më sipër Bordi i Akreditimit dha vlerësim pozitiv për akreditim me dy vite, duke rekomanduar:

1. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke e përshtatur atë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij program studimi, duke e bërë atë më të përshtatshme për këtë program studimit, si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë, të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm
3. Institucioni, të rishikojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, në drejtim të:
 - përputhjes së objektivave të shprehura në syllabuse me qëllimin e këtij programi studimi si dhe me nivelin e të nxënësve të studentëve të këtij programi studimit,
 - shmangies së përsëritjes së temave të përfshira në syllabuset e programit të studimit,
 - përditësimit të literaturës së përfshirë në syllabuset e programit të studimit.
4. Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe të rishikojë kompetencat e synuara të këtij programi, në përputhje me nevojat e tregut.
5. Institucioni të përdorë një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, në funksion të këtij programi studimi.
6. Institucioni, të marrë masa për të rritur qëndrueshmërinë e personelit akademik dhe atij administrativ, të angazhuar në këtë program studimi.
7. Institucioni, të marrë masa për përmirësimin e procedurave në raport me kodifikimin e provimeve dhe administrimin e komponentëve të vlerësimit nga sekretaria mësimore.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1 .Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke e përshtatur atë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, DESF ka marrë masa për t'ia përshtatur kurrikulën e këtij programi studimi VKM Nr.185, datë 25.03.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, duke shtuar orët e praktikës profesionale, provimin e formimit dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese të këtij vendimi. **[Evidenca A.3.4. Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]**

1 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht

2. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, duke e bërë atë më të përshtatshme për këtë program studimi, si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë, të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, DESF ka marrë masa që kurrikula e këtij program studimi të jetë me lëndë sa më praktike, që i përshtaten këtij profili. Në ndryshimin e bërë këtij plani mësimor në masën 20% janë shtuar lëndët "Etika e Biznesit", "Bazat e Menaxhimit", janë ndryshuar kreditet tek trajnimet praktike dhe është shtuar provimi përfundimtar.

[Evidenca A.3.4. Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]

2 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

- *3.Institucioni, të rishikojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, në drejtim të:*
- *përputhjes së objektivave të shprehura në syllabuse me qëllimin e këtij programi studimi si dhe me nivelin e të nxënit të studentëve të këtij programi studimi,*
- *shmangies së përsëritjes së temave të përfshira në syllabuset e programit të studimit,*
- *përditësimit të literaturës së përfshirë në syllabuset e programit të studimit.*

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, stafi akademik në funksion të këtij programi studimi ka realizuar ndryshimin e programeve lëndore (syllabuseve) në drejtim të:

1. Objektivat e këtyre lëndëve u realizuan që të jenë në funksion të nxënies së studentëve dhe në aplikimin praktik të njohurive të marra prej tyre, duke qenë sa më pranë anës praktike profesionale dhe sa më pranë nevojave të tregut të punës,



2. Shmangia e përsëritjes së temave të caktuara për t'ia përshtatur sa më mirë nivelit të studentëve të këtij program, duke i dhënë njohuri dhe kompetenca të përshtatshme për asimilimin sa më të mirë të njohurive praktike,
3. Procedura e çdo fillim viti në departament është rishikimi i syllabuseve për përditësimin e literaturës në funksion të pasurimit me informacion dhe tema të reja në funksion të anës praktike të këtij programi profesional.

[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të programit të studimit]

3 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

Me gjithë ndryshimet e bëra, në një pjesë të syllabuseve temat dhe çështjet e përfshira dhe literatura bazë e paraqitur tejkalojnë objektivat e programit profesional dhe nivelin e të nxënit të studentëve të këtij programi.

4 Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe të rishikojë kompetencat e synuara të këtij programi, në përputhje me nevojat e tregut.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Departamenti ka realizuar një studim të mirëfilltë të tregut të punës duke u nisur nga statistikët, raportet dhe dinamikat socio-ekonomike. **[Evidenca A.3.3, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH]**

4 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

5. Institucioni të përdorë një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, në funksion të këtij programi studimi.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Institucioni ka aktualisht një portal studentit në të cilin studentët mund të aksesojnë notat e vendosura nga sekretaria. Në funksion të përmirësimit të tij, Institucioni ka marrë masa që së shpejti të vihet në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe administrativ një sistem i brendshëm për menaxhimin e informacionit në lidhje me leksionet, lëndët, notat dhe çdo aktivitet tjetër që duhet të jenë në dijeni studentët. Zyra e TIK-ut ka realizuar një udhëzues brenda të cilit ndodhet edhe sistemi i brendshëm për menaxhimin e informacionit.

[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]

5 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

Megjithë masat e ndërmarra dhe përgatitjet e vlerësueshme për përdorimin e një sistemi të brendshëm për menaxhimin e informacionit, ky system ende nuk është bërë funksional.

6. Institucioni, të marrë masa për të rritur qëndrueshmërinë e personelit akademik dhe atij administrativ, të angazhuar në këtë program studimi.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, Institucioni ka marrë masa për të ruajtur qëndrueshmërinë e stafit akademik me kohë të plotë dhe atij administrativ të angazhuar në këtë program studimi. *[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] dhe [Evidenca A.1.6.1. Prot.1044 datë 1.10.2023, Dërgohet lista e stafit akademik me kohë të plotë për Vitin Akademik 2023-2024]*

6 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

7. Institucioni, të marrë masa për përmirësimin e procedurave në raport me kodifikimin e provimeve dhe administrimin e komponentëve të vlerësimit nga sekretaria mësimore.

Plotësimi i rekomandimit (sipas RVB)

Në zbatim të rekomandimeve të bordit të akreditimit të sipërcituara në pikën 7, Institucioni ka marrë masa për përmirësimin e procedurave të kodifikimit të provimeve, duke respektuar Rregulloren e UniBa, ref. Neni 88 “Forma e Kontrollit” dhe aktet e brendshme rregullatore UniBa. *[Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa] dhe [Evidenca A.3.13, Vendim Rektorati, Nr. 94 dt. 12.02.2021 “Për miratimin e formatit të provimeve, etj”]*

7 Komenti i GVJ: GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

Lidhur me komentin e IAL U Barleti për këtë program studimi me shkresë Nr Prot 1212 dhe datë 08.10.2024

Komenti i referohet fushës 3 standardi III 5

Sqarojme se rekomandimi i GVJ per kete program lidhet me menyren se si njesite pergjegjese informojne studentet, i ndihmojne ata te pergatiten dhe realizojne provimin perfundimtar.

Rekomandimi i GVJ nuk lidhet me formen e detyrimeve permbyllese (provim perfundimtar apo teme diplome), perkundrazi konfirmohet provimi perfundimtar si forma e realizimit te tyre.

Rekomandimi ka lidhje me faktin e evidentuar edhe ne Standardin V.2, Kriteri 4, te shprehur si vijon: "Duke qenë viti i parë i aplikimit të kësaj procedure përmbyllëse për programin TOBMSH, janë të kuptueshme paqartësitë lidhur me këtë program orientues dhe detyrim te studentët e vitit të dytë. Besojmë se përvoja e këtij viti akademik do të lehtësojë informimin dhe përgatitjen në kohë për këtë proces."

Ne kete aspekt mund te aplikohet pervoja e programeve te tjera brenda njesive dhe institucionit.

Two handwritten signatures in black ink are located at the bottom right of the page. The first signature is a stylized, cursive 'Jy' and the second is a cursive 'Ru'.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i arsimit të lartë UniBa ofron programe studimi të hartuara bazuar në standardet kombëtare dhe eksperiencën të ndryshme ndërkombëtare, të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare, dhe njëkohësisht bën përpjekje të vlerësueshme për të ruajtur dhe konsoliduar jo vetëm vlerat akademike por edhe vlerat kulturore kombëtare. Vihet re se tregohet kujdesi i nevojshëm për hartimin e çdo programi mësimor për të bërë një kombinim sa më të mirë lidhur me vlerësimin e duhur të zhvillimit dinamik social-ekonomik të vendit dhe arritjeve të nevojshme akademike. Institucioni arsimor UniBa ka ndërtuar kurrikula akademike dhe përdor metoda të mësimdhënies duke u fokusuar që të jenë sa më rigorozë, duke mbajtur parasysh që studentët të pajisen me njohuri, aftësi dhe vlerat e duhura me qëllim që ata të përgatiten sa më mirë për të qenë specialistë të aftë dhe për të kontribuar në zhvillimin e vendit duke u fokusuar njëkohësisht në identitetin kulturor kombëtar. Ky program bazuar edhe në veçantinë e tij përpaket të theksoj sa më shumë qasjet ndërdisiplinore dhe të nxisi të kuptuarit sa më të mirë dhe mendimin kritik të studentëve. Gjithashtu, ky program zgjeron kulturën intelektuale dhe profesionale të studentëve dhe i nxit ata të fokusohen në përgjegjëshmërinë e tyre për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Duke investuar vazhdimisht në stafin akademik, UniBa ka ndërtuar këtë program dhe programe të tjera bazuar në interesat kombëtare duke u fokusuar në mbrojtjen e studentëve me vlera kombëtare. Përmes kësaj pune UniBa bën përpjekje të vlerësueshme për formimin e specialistëve të ardhshëm që duhet të jenë të përkushtuar në punë dhe me integritet njerëzor dhe kombëtar. <i>[Evidenca A.1.1, Statuti UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa]</i> <i>[Evidenca A.2.1, Rregullore FEQD]</i> <i>[Evidenca A.2.2, Rregullore e DESF]</i> <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030]</i>

Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në detyrimet ligjore dhe akademike UniBa ka hartuar dhe ka aprovuar në organet drejtuese “Strategjinë e zhvillimit insititucional për periudhën 2020-2030”. Nga komunikimi me stafin gjatë vizitës në UniBa na u theksua se kjo strategji është hartuar nga një grup pune që ka marrë në konsideratë mendimet e stafit të brendshëm dhe të drejtuesve akademikë por njëkohësisht ka marrë edhe gjykimin e disa ekspertëve të jashtëm të arsimit të lartë si dhe të sipërmarrësve që janë partnerët kryesor dhe më të rëndësishëm të UniBa. Zbatimi i saj është i reflektuar në të gjitha programet sipas cikleve të studimit dhe edhe në progamin TOBMSH, duke u fokusuar tek arritjet akademike me synimin kryesor rritjen e efikasitet gjatë procesit mësimor, duke u bazuar në qëllimin parësor dhënien studentëve të dijeve sa më bashkëkohore në fushat e biznesit, marketingut, dhe komunikimit. Kjo gjë ka shkuar paralel me rritjen cilësore të stafit akademik, të cilët kanë objektiv kryesor rritjen e tyre profesionale. Bazuar në faktin se programi që po vlerësojmë ka në fokus njohuritë aplikative dhe në përmbushjen e objektivit të UniBa për përgatitjen e këtyre studentëve jo në mënyrë akademike, por me dije të thelluara profesionale, theksojmë se programi Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje (TOBMSH) bazohet dhe ka në themelet e tij edukimin profesional të studentëve të kombinuar me njohuri të caktuara teoriko akademike. Programi i studimit TOBMSH është program që mbulohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF), që është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) dhe zhvillohet bazuar në strategjinë institucionale <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq. 7]</i>. Bazuar në dokumentacionin që na u vu në dispozicion theksojmë se programi i studimit TOBMSH ka si qëllim kryesor të mbështesë rritjen e njohurive të studentëve në fushat ku fokusohet programi si zhvillimi i biznesit, shitjet dhe marketingu dhe tenton në përgatitjen e studentëve duke i aftësuar ata për tu bërë specialistë të mirë në një treg ku konkureshmëria është agresive dhe në rritje të vazhdueshme. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur theksojmë se programi TOBMSH ka si fokus bazë dhënien e njohurive teoriko praktike me qëllim që mbas përfundimit të studimeve, studentët të kenë njohuri të thelluara për përmirësimin e mënyrës së funksionit të bizneseve, rritjen cilësore të tyre në treg, rritjen e potencialit konkures për produktet dhe shërbimet që ofrohen nga bizneset e ndryshme. Ky program është dizenuar dhe është organizuar bazuar në fokusin e tij si program profesional 2-vjeçar, duke u mbështetur në zbatimin e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
--	--

	[Evidenca A.1.18, Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit] Fokusi i departamentit të Financës, Ekonomisë dhe Sipërmarrjes, është që përmes këtij programi të arrihet dhënia e njohurive bashkëkohore për studentët dhe për këtë janë krijuar kurrikula të cilat përmirësohen vazhdimisht, kurrikula të cilat zbatohen nga një staf akademik që punon vazhdimisht për ngritjen e tyre profesionale, për të qenë aftë për të transmetuar tek studentët dije bashkëkohore teoriko praktike në fushën e biznesit. Departamenti punon vazhdimisht për rritje cilësore akademike dhe bazuar në vlera kombëtare për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe për të pasqyruar zhvillimet bashkëkohore teoriko praktike, duke u bazuar në rregullat e brendshme të UniBa por edhe në lirinë akademike dhe përgatitjen e stafit mbështetës që kontribuon për mbarëvajtjen e TOBMSH.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Statuti është dokumenti bazë mbi të cilin funksionon UniBa. Bazuar në rregullat në fuqi, ky statut është miratuar nga MASR me Urdhër nr. 360, dt. 23.12.2020 [Evidenca A.1.1, Statuti UniBa]. Gjithashtu dokument bazë është edhe Rregullorja Akademike [Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa], e cila përmirësohet herë pas here bazuar në situatat konkrete të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Statuti përcakton qartë drejtimit strategjike të institucionit me synim edukimin ndërdisiplinor të individëve të angazhuar [Evidenca A.1.1, Statuti, neni 5], respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor [Evidenca A.1.1, Statuti, neni 3, pika 2] dhe shtyllat kryesore të aktivitetit akademik përmes strukturës dhe ofertës akademike [Evidenca A.1.1, Statuti, neni 6]. Rregullorja akademike e institucionit përcakton qartë drejtimit prioritare akademike përmes hartimit të rregullave kryesore të organizimit dhe funksionimit të procesit mësimor. [Evidenca A.1.3, Rregullore e UniBa, neni 2]. Të dy këto dokumenta themeltar janë bazë për të gjitha programet, përfshi edhe TOBMSH. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit TOBMSH janë ndërtuar në përputhje të plotë me një nga fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim-zhvillimit të UniBa: Ekonomi, Biznes-Turizëm-Evente [Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023, fq. 11]. Vihet re se përmbajtja e programit të TOBMSH është hartuar duke u përpjekur për të zhvilluar kompetenca profesionale të studentëve, në kuadër të formimit ndërdisiplinor të tyre në fushën e biznesit, marketingut dhe shitjeve, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e dijeve bashkëkohore [Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023, fq. 10]. Ky program i është nënshtruar ndryshimeve të vogla (deri 20%) bazuar në vrejtjet e

	akreditimit si edhe në konceptimet më bashkëkohore nga stafi akademik.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në UniBa vihet re se programi TOBMSH është hapur bazuar në eksperiencat pozitive në Shqipëri dhe në vende të tjera dhe për këtë gjë janë zhvilluar konsultime intensive me specialistë të fushave që mbulon ky program. Studimet në programin TOBMSH kanë karakter profesional dhe në përgjithësi ato synojnë përgatitjen praktike të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për të qenë specialistë të aftë në punën e përditëshme mbas kryerjes së studimeve. <i>[Evidenca A.3.1, Licensimi i programit TOBMSH me Urdhër 568, dt. 12.9.2018].</i> Bazuar edhe në vërejtjet e marra ky program i është nënshtruar përmirësimit të kurikulës për të qenë më dinamik duke ndjekur zhvillimet dhe nevojat aktuale socio ekonomike të vendit. Në këtë program janë rishikuar silabuset e disa lëndëve, dhe ndryshuar kurrikulat. Këto ndryshime janë bazuar në studimin mbi tregun e punës <i>[Evidenca A.3.5, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH]</i> si dhe pas konsultave me partnerë të cilët ofrojnë praktikën profesionale të të diplomuarve. Bazuar në studimin e tregut të punës ku paraqiten edhe kërkesat për këto nivele specialistësh si: menaxher shitjesh, marketier apo agent marketingu janë bërë edhe disa përmirësime në programin mësimor. Programi i studimit është ndërtuar me qëllim që pas diplomimit, studentët të kenë njohuritë e nevojshme që të punësohen në biznese të ndryshme në fushën e shitjeve dhe marketingut, në biznese dhe institucione të ndryshme.
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UniBA vumë re se ky institucion ka një përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe njohuri praktike në fushën e ekonomisë. Bazuar në këtë përvojë është ndërtuar plani mësimor i programit TOBMSH i cili bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 6 pika 25, neni 70 pika 1 dhe neni 72 pika 1, si dhe të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 "Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", VKM 879/ 2019 dhe VKM 185/ 2021. Sipas përcaktimeve, plani mësimor i programit të studimit në TOBMSH është i organizuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra, me lëndë e module të vlerësuar me kredite. Planin mësimor është i ndërtuar bazuar në 4 gruplëndësh, 10 lëndë me 20 module ku përfshihet edhe Trajnimi Praktik. Çdo modul ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ngarkesën totale në orë, ngarkesat javore dhe orët

	individuale <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9].</i> Programi i studimit TOBMSH ka në përbërjen e tij lëndë, me emërtime e ngarkesa dhe tenton të ketë një raport sa më të balancuar midis teorisë dhe praktikës, për të qenë në përputhje të plotë me objektivat e programit. Plani mësimor dhe kurrikulat e lëndëve janë ndërtuar, duke marrë parasysh eksperiencën të ndryshme të programeve të ngjashme kombëtare e ndërkombëtare dhe lëndët/modulet e tij transmetohen tek studentët nga një staf profesionist në fushat që mbulon ky program <i>[Evidenca A.3.11, CV e stafit akademik të programit të studimit].</i>			
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit bazohet dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane <i>[Evidenca A.1.31, Prot. 431 (Dt. 27.03.2023) MAS - Dërgohet përgjigja për Kodifikimin e programeve].</i> E ritheksojmë se plani mësimor i programit TOBMSH është ndërtuar dhe realizohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 <i>[Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 6 pika 25, neni 70 pika 1 dhe neni 72 pika 1]</i> dhe të VKM “Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”. Plani mësimor është i organizuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra, me gruplëndësh, lëndë e module të vlerësuar me kredite, përfshirë edhe Trajnimin Praktik. Secili modul ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve (ECTS), ngarkesën totale në orë, ngarkesat javore dhe orët individuale. <i>[Evidenca A.3.4, Plani mësimor për programin e studimit TOBMSH i ndryshuar në masën 20%]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9].</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UniBa ofron programe studimi në mbështetje të interesave kombëtare, duke konsoliduar vlerat akademike e kulturore kombëtare. Veprimtaria kryhet bazuar në qëllimet dhe misionin e UniBa dhe veprimtaria kryhet sipas strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores duke u mbështetur në studime të tregut të punës. UniBa ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit 2 vjeçar TOBMSH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga materialet e vëna në dispozicion si dhe nga vizita në UniBa vëmë re se tregohet kujdesi i duhur lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit duke krijuar një bashkëpunim të frutshëm të personelit me qëllimin final për të ndërtuar një program sa më të përshtatshëm në zbatim të objektivave të tij. Gjithashtu vihet re se këto programe janë konsultuar edhe me bizneset dhe ekspertë dhe specialistë të jashtëm për të patur sukses gjatë procesit të ri-akreditimit të programit TOBMSH. Në përgatitjen e programit TOBMSH ka një ndërthurje të mirë të stafit me eksperiencë, pedagogëve të rinj dhe specialistëve të bizneseve të ndryshme duke realizuar nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit jo vetëm brenda institucionit por edhe me specialistët e praktikës sepse ky është një program profesional. Elementet kryesore të këtij procesi përfshijnë: Ideimi Strategjik, duke bërë vlerësimin e nevojave dhe pritshmërive të palëve të interesuara si edhe përgjigja që duhet të jap programi Zhvillimi i një plani strategjik ku është vënë fokusi tek treguesit kryesorë të performancës së programit. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe midis stafit akademik, atij administrativ dhe mbështetës. Transparenca në ndarjen e detyrave si dhe vlerësimet periodike të komponentëve të programit. Aplikimi i mekanizmave të sigurimi të cilësisë për të monitoruar elementët e ndryshëm të programit <i>[Evidenca A.1.28, Plan Pune NJZHKC 2023-2024]</i>. Institucioni ka mundur të krijojë një mjedis pozitiv dhe bashkëpunues për të mbështetur hartimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e programit të studimit nga ana profesionale dhe akademike. Bazuar në vërejtjet e mara nga akreditimi programi i TOBMSH, u përmirësua bazuar në një studim tregu të realizuar dhe njëkohësisht duke u bazuar në përvojën më të mirë të institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Programi i ndryshuar është miratuar në Senatin e universitetit dhe ai është bazuar në strategjinë dhe objektivat e UniBa dhe të departamentit. <i>[Evidenca A.2.2, Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, neni 5].</i>

	Përgjegjësi i departamentit organizon mbledhje periodike ku trajtohen problematikat për zbatimin e programeve që janë nën këtë departament. Në fund të çdo viti akademik organizohet mbledhja e departamentit ku mes problemeve të tjera prezantohet dhe analizohet raporti final për ecurinë e programit TOBMSH, gjithashtu miratohet raporti i analizës së aktivitetit të departamentit për vitin akademik ku përfshihet edhe TOBMSH <i>[Evidenca A.2.4, Analiza vjetore e departamentit për vitin akademik, 2022-2023]</i>.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në këtë kuadër Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës ka inicuar dhe ka realizuar disa marrëveshje me institucione homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës që operojnë në fushën e menaxhimit, marketingut dhe shitjeve, të cilat janë përmbyllur me nënshkrimin e marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5]</i>. Këto marrëveshje kanë për qëllim të realizojnë trajnimet praktike të studentëve të programit TOBMSH, duke kombinuar njohuritë teorike me ato praktike. Për këtë program praktika mësimore zhvillohet në të dy semestrat e vitit akademik. Përgjatë dy viteve të fundit akademikë rezultojnë se 13 (trembëdhjetë) studentë të programit profesional në TOBMSH kanë kryer praktikën pranë organizatave/ institucioneve publike/ private, si: “Novus Marketing and Advertising” dhe “Iceberg Communication”. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, janë nënshkruar 29 marrëveshje bashkëpunimi të reja me institucione publike/ private vendase dhe të huaja, si dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj, si: REMAX Empire (2022), Çelësi Media Group (2022), Iceberg Communication (2022), Dhoma Ekonomike e Gruas (2022), Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë (2023), Tobacco Holding Group (2023), British American Tobacco (2023), FIX PRO (2023), NEXT Albania (2023), KNC shpk (2024), Fondacioni “Tradita Popullore” etj. <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5]</i>.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të	Në kuadër të programit TOBMSH realizohet kombinimi i njohurive teorike me praktikën mësimore për të realizuar përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Për këtë plani mësimor i programit është konceptuar dhe organizuar që të jetë sa më praktik, duke përgatitur dhe aftësuar studentët për kërkesat dhe standartet që kërkon tregu i punës në vend <i>[Evidenca A.3.6, Strategjia e</i>

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	zhvillimit të programit të studimit, fq. 1]. Në këtë program, studenti është i detyruar të ndjek praktikat mësimore të parashikuara në planin mësimor. Dokumentacioni, procedura dhe afatet parashikohen në Paketën e Praktikës, të miratuar nga Senati Akademik. Praktikrat mësimore kryhen në institucionet bashkëpunuese dhe nën mbikëqyrjen e një pedagogu të caktuar nga Departamenti, mbi bazën e marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, modeli i së cilës është pjesë e paketës së praktikës. Nëpërmjet orëve të praktikës studenti zhvillon aftësitë profesionale dhe praktike për t'u përgatitur me cilësitë e nevojshme që i lehtësojnë integrimin në tregun e punës. [Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për programet me karakter profesional, fq. 1]. Aktualisht departamenti si pjesë e UniBa ka nënshkruar 29 marrëveshje bashkëpunimi aktive me organizata dhe institucione të fushës, të cilat synojnë të realizojnë zhvillimin e praktikave profesionale për studentët, me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e këtyre organizatave [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5].
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Bashkëpunimi i suksesshëm me partnerët është në fokusin e përhershëm të departamentit ku është përfshirë programi TOBMSH prandaj departamenti në mënyrë të vazhdueshme, me mbështetjen e institucionit, organizon dhe zhvillon takime me drejtues të organizatave në sektorët e sipër cituar, për të zgjeruar gamën e bashkëpunimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të programit TOBMSH [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5]. Departamenti organizon mbledhje periodike ku analizonë arritjet dhe sfidat në këto bashkëpunime. Departamenti harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit [Evidenca A.3.9.1. Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit]. Praktikrat mësimore u nënshtrohen të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, ashtu sikurse për të gjitha detyrimet e tjera.
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Zyrat studentore në bashkëpunim me Departamentin organizojnë rregullisht takime me studentët për t'i informuar mbi programin e studimit dhe dobinë e tij, në mënyrë që studentët të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm. Zyra "Alumni Karriera" në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti si Barleti Human Capital, Barleti Hub dhe BTTC zhvillojnë aktivitete trajnuese për të afruar dhe përgatitur studentët me tregun e punës [Evidenca Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 - 2025].



	Gjatë vizitës u informuam se për programin e studimit TOBMSH, për vitin akademik 2020-2021, janë diplomuar 4 (katër) studentë dhe rezultojnë se të gjithë janë të punësuar, në vitin 2021-2022 janë diplomuar 8 (tetë) studentë dhe këtë vit akademik kanë filluar studimet në këtë program 13 studentë (Tabela 21), të cilët janë në proces studimi <i>[Evidenca A.3.12, Tabela përmbledhëse për RVB]</i> dhe <i>[Evidenca A.3.9.1. Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i> .			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumenta dhe vizitën në UniBa thekson se ka marrëdhënie të mira bashkëpunimi brenda institucionit midis njësive dhe personelit, duke krijuar bashkëpunim me institucione të ndryshme dhe me biznesin. UniBa ka marrëveshje të qëndrueshme me institucione dhe kompani të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës. UniBa i bënë përpjekjet e duhura në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Struktura Organizative e UniBa-s është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015 dhe kjo gjë shprehet në mënyrën e organizimit dhe në ndarjen e funksioneve të cilat paraqiten në detaje në statutin e UniBa, në rregulloren e përkatëse dhe në aktet e tjera të UniBa. UniBa ka hartuar politika dhe procedura të përcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kodin e cilësisë dhe praktikën bashkëkohore. Sipas informacionit të marr, strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UniBa janë: ➤ Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe të Cilësisë, ➤ Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë. Gjithashtu, të dyja këto struktura punojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore: 1) Rregullorja e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë 2) Rregullorja e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë,

	Theksojmë se organizimi dhe funksionet e tyre parashikohen në Statutin e institucionit, në nenet 10 dhe 28, në rregulloren e UniBa, në nenet 14 dhe 15. Gjithashtu në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s (neni 15), por dhe vlerësimin e procesit akademik, kërkimor, sektorit të çështjeve studentore, vlerësimin e marrëdhënieve me komunitetin, vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional, etj. [Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti] [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] [Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.19.1, Vendim Nr. 46, datë 24.11.2023] “Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa] [Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së], [Evidenca A.3.12, Anëtarët e NJZHKC-së në UniBA, Tabela 24] [Evidenca A.1.17, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UniBa ka ngritur edhe disa struktura të tjera të cilat shërbejnë për të përmbushur strategjinë e UniBa në sigurimin e cilësisë. Kështu, Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë bashkëpunon me Zyrën e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës, Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Zyrën e Pranimeve, Dekanin e studentëve, njësitë bazë e kryesore, studentët alumni dhe me bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm. Në strategjinë UniBa 2020-2030 janë parashikuar disa objektiva të matshëm për të matur përmirësimin e cilësisë së jetës akademike. si mësimdhënia, punësimi i të diplomuarve, përmirësimi i kurrikulave pasurimi i bibliotekës, mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA, ndërkombëtarizimi etj. Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Performancës jep sugjerime dhe rekomandime në funksion të përmirësimit të kulturës së cilësisë në Institucion. Rekomandimet e komisionit përmbledhen në udhëzime të Rektorit për zbatim [Evidenca A.1.4, Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030].
Kriteri 3. Institucioni përdor	UniBa ka ndërtuar instrumente për sigurimin e cilësisë së

instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	programeve të studimit ku përfshihen: formulari vlerësimit të studentëve për lëndën (pyetësorët anonimë), formulari mbi transparencën e vlerësimit, formulari i vlerësimit midis kolegëve, si dhe raporte të vlerësimit të studentëve për pedagogët, lëndën dhe programin. Sipas rregullave ligjore në fuqi, në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UniBa i nënshtrohet vlerësimit periodik institucional dhe të programeve të studimit. Raporte të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit gjenden në intranet, dhe publikohen në faqen web të UniBa. [Evidenca A.1.11, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën] [Evidenca A.1.32, Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve] [Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegj me kolegë]			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Në UniBa si rregull dhe periodikisht çdo anëtar i stafit me kohë të plotë raporton mbi angazhimin e tij gjatë semestrit. Ky raportim përfshin: angazhimin në mësimdhënie, trajnime, projekte, punë kërkimore, punë administrative. Përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin për anëtarët e stafit bazuar në këtë vetëdeklarim dhe në dokumentat përkatës. Të dhënat që lidhen me angazhimin në mësimdhënie kryqëzohen me të dhëna që merren edhe nga sekretaria. Në varësi të rezultateve që arrihen, bazuar edhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Institucioni merr vendimet përkatëse, si emërimin në pozicione të caktuara, mbulimin e një pjese të shpenzimeve për konferenca apo aktivitete të tjera kërkimore [A.1.37 Promovim i shembujve të praktikave të mira]. Ky proces diskutohet edhe në mbledhjet e departamentit dhe pasqyrohet në raportin e punës vjetore të Institucionit. [Evidenca A.1.15, Format i Raportimit të Punës Semestrale] [Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UniBa ka ndërtuar politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC) duke u bazuar në strategjinë institucionale dhe duke përdorur instrumentet dhe treguesit për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë. Përpjekjet e UniBa promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë përmes treguesve të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor duke realizuar promovimin e arritjeve më të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit TOBMSH realizohet duke u bazuar në planin mësimor ku përfshihen lëndë dhe module të vlerësuara në kredite, që kanë të përcaktuar tipin e veprimtarisë sipas kategorive A-E, ngarkesën orare javore dhe sipas ndarjes në auditor/ studim i pavarur, si dhe format e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar. Totali i krediteve të përfituara në përfundim të studimeve është 120 ECTS. Programi është i organizuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor respekton kërkesat e udhëzimeve të MAS për organizimin e programeve të studimit të nivelit përkatës. <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, nga takimet në institucion dhe dokumentat shtesë pas vizitës, evidentohet se programi TOBMSH ka si qëllim bazë dhënien e njohurive teoriko praktike për menaxhimin e operacioneve, zhvillimin e biznesit, shitjet dhe marketingun, të cilat ju ofrojnë studentëve aftësi dhe kompetenca të nevojshme dhe të kërkuara në tregun e punës. Kombinimi i njohurive që paraqet plani mësimor i programit të studimit, i realizuar me kujdes gjatë zbatimit të tij, do ju mundësojë studentëve që pas përfundimit të studimeve, të kenë njohuri të mjaftueshme, por jo domosdoshmërisht të thelluara, për përmirësimin e mënyrës së funksionimit të bizneseve, rritjen cilësore të tyre në treg, rritjen e potencialit konkurrues për produktet dhe shërbimet që ata ofrojnë në një diapazon të gjerë aktiviteteve biznesi.

specializuar profesionale.	Programi ofron njohuri dhe kompetenca të përparuara nga të cilat mund të përfitojnë edhe prakticienë që kërkojnë të rrisin kualifikimin dhe përditësojnë njohuritë profesionale. <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca 8 sipas listës së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ]</i> https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Formimi i një profili profesional të teknikut të lartë në fushën e biznesit, marketingut dhe shitjeve evidentohet përmes objektivave që programi shpreh në dokumentat e tij. Dallohen objektivat për pajisjen e studentëve me aftësi njohëse dhe praktike që nevojiten: - për të gjetur zgjidhje krijuese për probleme në fushën e biznesit dhe marketingut, - për demonstrimin e aftësive për planifikim, organizim dhe kontroll të veprimtarive të punës, - për kontroll dhe mbështetje për personelin, duke siguruar shpjegime ose udhëzues për të realizuar një veprimtari specifike në fushën e studimit, Objektivat e programit në tërësi janë optimiste dhe përfshijnë praktikisht një fushë studimi mjaft të gjerë, duke integruar operacionet e biznesit, strategjinë e marketingut dhe teknikat e shitjeve (ref. "Strategjia e zhvillimit të programit"). Arritja e tyre mundësohet përmes zbrërthimit dhe reflektimit të këtyre objektivave në mënyrë të ekuilibruar në komponentët formues të lëndëve/ moduleve të programit. <i>[Evidenca A.3.6, Strategjia e zhvillimit të programit të studimit]</i> <i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës 2022-2023].</i> https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Plani mësimor i programit të studimit TOBMSH është i organizuar në 2 vite akademikë me 4 semestra. Plani mësimor i ndryshuar (sipas tabelës 10) përfshin lëndë dhe module të shtrira në të dy semestrat e të dy viteve, të vlerësuar me kredite, në total 120 ECTS. Plani paraqet 11 module dhe 2 trajnime praktike në vitin e parë, me një total kreditesh prej 60 ECTS. Në vitin e dytë, sipas planit, zhvillohen 9 module dhe 2 trajnime të tjera praktike, si edhe realizohen detyrimet përmbyllëse në formën e provimit përfundimtar me 6 kredite, gjithashtu me një total vjetor prej 60 ECTS. Trajnimet praktike, që mund të emërtohen Praktikë

	profesionale, në përputhje me emërtesën e veprimtarisë formuese ku përfshihen, janë secila me nga 3 kredite, gjithsej 12 kredite. Në tërësi, programi i studimit paraqet korrektësisht lëndët/modulet, tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), orët mësimore dhe ngarkesat javore. A, 10%-15% (18 kredite) lëndë bazë B, 50 %– 55 % (66 kredite) lëndë karakterizuese C 5 %-15 % (12 kredite) lëndë ndërdisiolinore/ integruese D 10 %- 15%(18 kredite) lëndë plotësuese E 3 %- 5 % (6 kredite) detyrime përmbyllëse <i>[Evidenca shitesë: Plani Mësimor për programin e studimit sipas modelit të Tabelës 10]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9]</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe nga takimet në institucion evidentohet se UniBa ka zbatuar kërkesën ligjore për të bërë kodifikimin e programit të studimit TOBMSH duke dërguar propozimin pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kodi i përcaktuar përkon me fushën e studimit dhe klasifikimet e bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>[Evidenca A.1.31, Prot. 431(Dt.27.03.2023) MAS-Dërgohet propozimi për kodifikimin e programeve të studimit]</i>
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se programi i studimit TOBMSH realizohet në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, me Sistemin</i>

	<i>European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe në zbatim të akteve rregullatore të institucionit. Plani mësimor respekton kërkesat e udhëzimeve të MAS për organizimin e programeve të studimit të nivelit përkatës dhe përfshin lëndë, module dhe veprimtari të vlerësuara në kredite. Programi ka si qëllim dhënien e njohurive teoriko praktike për menaxhimin e operacioneve, zhvillimin e biznesit, shitjet dhe marketingun, të cilat ju ofrojnë studentëve aftësi dhe kompetenca të nevojshme dhe të kërkuara në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit TOBMSH është pjesë e ofertës akademike që ofron Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, njësi kryesore e Universitetit “Barleti” Aktualisht U Barleti ka në përbërje katër fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative Fakulteti i Shkencave Mjekësore FEQD, funksionon në zbatim të Ligjit nr. 80 të vitit 2015 “Për arsimin e lartë. Kjo njësi kryesore është e organizuar në tre njësi bazë: Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës; Departamenti i Qeverisjes Shkencave Politike dhe Komunikim; Departamenti i Drejtësisë, përbërja e të cilave në aspektin e numrit të anëtarëve, gradave, raportit personel akademik efektiv/ me kontratë, përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi për strukturën akademike. Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës ka 2022-2023 11 PAE 16 PAK PAE 1 Prof.Dr, 2 Prof.As, 5 Dr, 3 Msc, PAK 1 Prof.Dr, 2 Prof.As, 9 Dr, 4 Msc 2023-2024 10 PAE 10 PAK

	PAE 1Prof.Dr,2 Prof As .Dr,6 Dr , 1 Msc PAK 1Prof.Dr,1Prof As.Dr, 4 Dr,4 Msc. Nga dokumentacioni i paraqitur konfirmohet se Institucioni dhe njësiti brenda tij, të lidhura me këtë program studimi, e zhvillojnë veprimtarinë e tyre duke plotësuar detyrimet ligjore për licensimin, vlerësimin dhe akreditimin. <i>[Evidenca A.1.1, Statuti UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.6.1. Lista e stafit akademik me kohë të plotë, Vendim Rektori me Prot.1044, datë 1.10.2023, për V.A. 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024]</i> <i>[Evidenca A.1.24, Vendim Nr. 571 dt 12.08.2005 - Dhënie leje për hapje të Institucionit]</i> <i>[Evidenca A.1.25, Prot. 71 (Dt. 20.01.2022) ASCAL - Përcillet Vendimi i Bordit të Akreditimit]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit TOBMSH, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, përbëhet nga 10 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 1 Prof.Dr 2 Prof.As. Dr, 6 Dr. dhe 1 Msc. Një pjesë e anëtarëve të departamentit janë të përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi, duke mundësuar mirëorganizimin dhe mbarëvajtjen e tij. Ky fakt evidentohet për të tre vitet akademike që përfshin vlerësimi i programit. Gjithashtu departamenti anagazhon 10 anëtarë si personel akademik me kontratë. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion (Tabela 4), programet lëndore dhe në konfirmimin gjatë vizitës në institucion, për praktikën mësimore dhe për zhvillimin e praktikave profesionale është ngarkuar stafi i departamentit. <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] Tabela 1 dhe 2, të rishikuara.</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës ka caktuar një anëtar të stafit të vet në detyrën e koordinatorit të këtij programi studimi, që kujdeset për ecurinë, mbarëvajtjen e programit dhe zhvillimin e praktikave profesionale. Kjo dëshmohet nga dokumentacioni i paraqitur dhe u konfirmua gjatë vizitës në takimin edhe me personin që kryen këtë detyrë, në përputhje me aktet rregullative të institucionit. Kujdesi i institucionit në këtë drejtim është i vlerësueshëm. <i>[Evidenca A.2.2, Rregullore e DESF, Neni 6]</i> <i>[Evidenca A.2.2.1, Vendimi Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 "Për miratimin e ndryshimit të nenit 6 të rregulloreve të departamenteve të Universitetit "Barleti"]</i>

	<i>[Evidenca A.2.3, Urdhri Nr.29, datë 14.10.2022 "Për emërim në detyrë të koordinatorëve të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për këtë program studimi, fakulteti dhe departamenti përkatës, përmbushin kriteret dhe kërkesat ligjore, duke mundur organizimin, monitorimin dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të programit në përputhje me objektivat e tij dhe konform standardeve të cilësisë, sipas nivelit të programit profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësitë përgjegjëse për programin e studimit TOBSH, përkatësisht FEQD dhe DESF, disponojnë informacionin mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, me hollësitë mbi planet mësimore, programet lëndore (syllabuset), Strategjinë e zhvillimit dhe rregulloren e programit të studimit. Njohja në dinamikë e historikut të zhvillimit të programit, përmirësimeve të kryera në planet mësimore dhe ndryshimeve në programet lëndore të tij do të ndihmonte njësitë përgjegjëse për programin për të mbajtur nivelin e arritur të tij dhe për ta avancuar më tej programin. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen zyrtare të universitetit: https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html ku mund të reflektohen përmirësimet e programit në vazhdimësi. <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca 8 sipas listës së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ – Relacioni mbi ndryshimet në planin mësimor TOBMSH]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i	Plani mësimor i programit TOBMSH jep informacion në lidhje me ndarjen e lëndëve/ moduleve në 4 semestra, ngarkesën mësimore të shprehur në kredite, gjithashtu të shprehur në orë në

nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit, format e kontrollit të dijeve, praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Plan i mësimor i programit që po realizohet gjatë vitit akademik 2023-2024 është përmirësuar në aspektin e pasqyrimin të këtij informacioni pas zbatimit të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit në akreditimin e parë të programit (shtator 2022). <i>[Evidenca A.3.4, Plan i Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca A.3.2, Akreditimi për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022]</i> <i>[Evidenca 8 sipas listës së dokumentave shitesë të kërkuara nga GVJ – Relacioni mbi ndryshimet në planin mësimor TOBMSH]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Paketa e plotë e dokumentacionit që lidhet me programin e studimit, përvec planeve mësimore, programeve lëndore dhe rregullores së programit, përfshin edhe dokumenta rregullatorë të institucionit UniBa ku përcaktohen proceset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Manuali për Rekrutim, Aplikim, Regjistrim, Transferim të UniBa ju vjen në ndihmë studentëve që të informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre. Ky informacion ofrohet edhe nga strukturat e posacme, si Zyra e Pranimeve dhe Regjistrimeve të UniBa, fakt që u evidentua në takimet me anëtarë të zyrës gjatë vizitës në institucion. <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore që i takojnë programit të studimit me karakter profesional TOBMSH në aspektin formal respektojnë formatin e miratuar në nivel institucioni dhe përmbajnë informacion të detajuar mbi objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar për studentin. Në këtë drejtim vërehet qëndrueshmëri në programet lëndore për tre vitet akademike që përfshin ky vlerësim. Për vitin akademik në vazhdim Evidenca A.3.10, Programet lëndore të programit të studimit, mund të ishte më e plotë, për të mundësuar gjykim objektiv për përfshirjen e të gjithë komponentëve formues në paketën e programit. <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>

Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësine bazë.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në takimet me GVB dhe me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program evidentohet që përmbajtja e programit të studimit TOBMSH ka kaluar në proces rishikimi dhe përmirësimi që nga akreditimi i parë. Ndryshimet në planin mësimor për vitin aktual dëshmojnë kujdesin e njësive përgjegjëse për të realizuar me korrektësi politikën institucionale të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve. I njëjti kujdes duhet të aplikohet edhe për sa i takon përmirësimeve në programet lëndore, në përmbajtjen e tyre dhe veçanërisht në drejtim të literaturës së përfshirë. <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca 8 sipas listës së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ – Relacioni mbi ndryshimet në planin mësimor TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>			
Konkluzione	Programi i studimit është i strukturuar dhe i organizuar, përmban informacionet e nevojshme për lëndët, ngarkesën mësimore, raportet e aktiviteteve formuese dhe detyrimet përmbyllëse, në përputhje me objektivat për formimin profesional të studentëve të këtij programi. Planin mësimor që po zbatohet aktualisht ka kaluar në proces rishikimi dhe përmirësimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit TOBMSH, në veçanti, pas ndryshimeve të planit mësimor, mundëson ofrimin e njohurive teorike dhe praktike në disiplina që i pajisin studentët me aftësi që të mund të ushtrojnë profesionin e teknikut të lartë profesional dhe të punësohen në përputhje me kualifikimin e

aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	fituar. Emërtimi i programit është në përputhje me fushat kryesore në të cilat studentët marrin njohuri dhe kompetenca, ku përfshihen kryesisht Marketing, Shitje, Programim dhe më pak Menaxhim. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në semestra dhe vite është përgjithësisht e përshtatshme për të mundësuar fillimisht dhënien e njohurive bazë dhe më pas thellimin e tyre deri në përfundim të studimeve, shoqëruar me aftësimin praktik në modulet e praktikës profesionale. [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Referuar dokumentacionit për vitet e kaluara dhe planit mësimor më të fundit, vënë në dispozicion pas kërkesës së GVJ, vërehet se njësitë përgjegjëse për programin kanë përmirësuar shpërndarjen e lëndëve/ moduleve gjatë semestrave dhe viteve. Kjo krijon kushte për arritjen e objektivave formues të secilës prej lëndëve dhe të programit në tërësi. Me gjithë ndryshimet, shpërndarja e lëndëve/ moduleve nëpër semestra dhe vite mund të përmirësohet, nëse mbahet parasysh lidhja konceptuale mes tyre dhe rritja graduale e shkallës së vështirësisë së koncepteve dhe aplikimeve që ofrohen gjatë zbatimit të programit. Shembuj të tillë janë: “Sisteme informacioni për marketing” i zhvilluar që në semestrin e parë të vitit të parë, paralelisht me bazat e marketingut dhe ndërkohë që “TIK në shkolla dhe shoqëri” renditet në semestrin e dytë. Në mënyrë të ngjashme zhvillohet lënda “Strategji për vendosje çmimesh” që në fillim të studimeve, kur studentët akoma nuk janë familjarizuar me koncepte dhe nuk kanë njohuri bazë mbi organizatën, prodhimin, menaxhimin e aktiviteteve, etj. Shtrirja në lëndë dhe nëpër semestra e praktikës mësimore dhe profesionale janë të përshtatshme dhe vlerësueshme për këtë program studimi. Nëse do të ishin në dispozicion syllabuset për të katër modulet e praktikës, sidomos për këtë vit akademik, do të mund të gjykohej më mirë për nivelin rritës, jo përsëritës, të aftësive dhe kompetencave që ju ofrohen studentëve në këto module. [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)] [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] Tabela 10, e rishikuar. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] Shënimet e GVJ gjatë takimeve në institucion
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të	Bazuar në planin mësimor dhe programet lëndore dhe duke konsideruar trajtimin në seminare dhe laboratorë si aktivitete të

balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	formimit praktik, kundrejt leksioneve si formim teorik, mund të themi se programi i studimit ka një raport të balancuar në këtë drejtim (rreth 50:50), të shprehur në orë mësimore. Trajnimet praktike (4 x 3 ECTS) të kombinuara me orët në laboratorë dhe orët e praktikës mësimore të disa lëndëve kryesisht në vitin e dytë e përmirësojnë raportin teori/ praktikë, duke kontribuar në qëllimin e programit të studimit që të formojë teknikë me aftësi praktike zbatimi. Bazuar edhe në informacionin gjatë vizitës, institucioni bën përpjekje të rrisë bashkëpunimin me bizneset që të mund të realizojë më shumë veprimtari praktike të studentëve të këtij programi. Programet e ngjashme vendase ose ndërkombëtare mund të merren si modele për të përmirësuar raportin teori/ praktikë gjatë zbatimit të këtij programi studimi në vazhdim. <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] Tabela 10, e rishikuar.</i> <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të plotësohen kërkesat për ndarjen sipas veprimtarive formuese dhe për të përcaktuar raportet midis formimit teorik dhe praktik. Në aspekt të arritjes së objektivave formues, pjesa më e madhe e lëndëve ofrojnë kreditet, orët mësimore dhe raporte teori/ praktikë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për punësimin në pozicionet që synohen me këtë profil punonjësi. Në aspektin e transferimit të studimeve dhe mobilitetit, struktura dhe përmbajtja e programit e mundësojnë dhe e gjithë praktika institucionale e mbështet atë. Efektiviteti i kësaj ndarjeje dhe raporteve teori/ praktikë do duhet të vlerësohet në vijim përmes raporteve mbi punësimin e të diplomuarve. Numri i të diplomuarve deri tani në këtë program është relativisht i ulët dhe i pamjaftueshëm për të gjykuar objektivisht për këtë efektivitet. <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabelat 9 dhe 23]</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë	Kuadri rregullator i institucionit dhe i programit të studimit përcaktojnë detyrimin dhe procedurat për përditësimin e programeve lëndore. Dokumentacioni në dispozicion dhe takimet me personelin akademik evidentojnë që programet lëndore kalojnë në procesin e përditësimit dhe miratimit sipas departamenteve nga burojnë përpara fillimit të vitit akademik, në konsultim dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Ndryshimet e lëndëve në planin mësimor të këtij programi (për 2023-2024) kanë qenë në ndihmë të këtij procesi.



dhe ndihmëse.	Sipas përshkrimit në RVB dhe deklarimeve të stafit, kujdes i kushtohet përditësimit të literaturës, fakt që evidentohet në krahasimin e syllabuseve ndërmjet viteve 2021-2022 dhe 2022-2023. I njëjti kujdes do duhej ti kushtohej edhe syllabuseve të këtij viti akademik, pasi vërehen raste të mbështetjes së lëndës në literaturën jo më të fundit ekzistuese në gjuhën shqipe. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] Shënimet e GVJ gjatë takimeve në institucion
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Praktika dokumentare mbi institucionin në tërësi dhe programin e studimit dëshmojnë një angazhim të vlerësueshëm për vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të tjera me qëllim aftësimin praktik të studenteve, në ndjekjen dhe vlerësimin e përfitimeve të studentëve gjatë praktikave, si edhe në realizimin e takimeve të studentëve me praktikienë dhe profesionistë që përcjellin tek ata kërkesat e profesionit. Ky fakt i fundit u evidentua në takimet me personelin akademik të programit, ashtu sikurse qartësia se në këtë drejtim nevojiten dhe institucioni bën përpjekje të vazhdueshme. [Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit] [Evidenca A.3.9.1, Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit] Shënimet e GVJ gjatë takimeve në institucion
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Lëndët/ modulet që përmban programi TOBMSH mundësojnë pajisjen e studentëve me aftësi dhe kompetenca profesionale dhe “të buta”/ soft skills, të domosdoshme për të plotësuar kërkesat e tregut dinamik të punës. Programi ofron një masë të konsiderueshme njohurish në fushën e marketingut dhe shitjeve, duke lehtësuar angazhimin e të diplomuarve kryesisht në pozicione të tilla në biznese. Në disa lëndë/ module, niveli i njohurive të ofruara (sipas temave dhe literaturës së përshkruar në syllabus) i tejkalon kërkesat dhe pritshmëritë për këtë program studimi të nivelit 5 të KSHK. Lehtësimi i tyre, duke i përshtatur me nivelin e programit profesional, ose duke i përputhur me mënyrën se si realizohen faktikisht në auditor (sipas deklarimeve të pedagogëve të lëndëve gjatë takimit), do të ishte i rekomandueshëm. [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)] [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] Tabela 10, e rishikuar. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]
Konkluzione	GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është përgjithësisht e përshtatshme për të mundësuar

	arritjen e objektivave formuese për tekniktët e ardhshëm në operacione biznesi, marketing dhe shitje. Shpërndarja e lëndëve/moduleve nëpër semestra dhe vite mund të përmirësohet më tej, duke mbajtur parasysh lidhjen konceptuale mes tyre dhe rritjen graduale të shkallës së vështirësisë së koncepteve dhe aplikimeve që ofrohen gjatë zbatimit të programit. Shtrirja në lëndë dhe nëpër semestra e praktikës mësimore dhe profesionale është e përshtatshme dhe e dobishme për aftësimin praktik të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit TOBMSH është një program 2 vjeçar që është disenuar për të dhënë njohuri themelore mbi metodat dhe konceptet themelore të funksionimit të ekonomisë dhe biznesit, duke u përqendruar në dhënien e njohurive sidomos praktike lidhur me menaxhimin e biznesit, marketingun dhe shitjen. Nën drejtimin e përgjegjësit të departamentit, i gjithë stafi i departamentit ka kryer takime të herëpashërshme me drejtues biznesesh të niveleve të ndryshme dhe me institucione të tjera arsimore që ofrojnë diploma të tilla për të shëmbyer mendime dhe për të marrë sygjerrime mbi zhvillimet koherente në tregun e punës dhe bazuar në këto informacione për të bërë ndryshimet e nevojshme në planet mësimore dhe në syllabuset përkatëse për të qenë në linjë me zhvillimet e biznesit dhe të ekonomisë.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Është praktikë e zakonshme në departamentin që mbulon TOBMSH përfshirja e studentëve dhe e strukturave studentore në diskutime dhe tërheqja e mendimeve të tyre si dhe kryhet konsultimi i vazhdueshëm me ata studentë që janë diplomuar për të tërhequr mendime dhe sygjerrime për përmirësime jo vetëm në programin mësimor por edhe në teknikat e mësimdhënies e sidomos për forcimin e lidhjesve me praktikën e biznesit. U informuam se ka takime të herpashërshme me alumnin dhe në këto takime ftohen edhe studentët aktual të TOBMSH.

	https://umb.edu.al/zyra-e-karrieres-dhe-alumni.html			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmrrajes dhe Financës, si departamenti që mbulon këtë program studimi ka në fokusin e vetë përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit në përputhje me eksperiencën e tyre dhe idetë dhe gjykimet e marra nga bizneset dhe akademikë që kanë programe të tilla studimi 2 vjeçare. Gjithashtu nga bashkëpunimi me kompani të ndryshme bazuar në marrëveshjet përkatëse merret dhe përpunohet informacion për përmirësimin e programit të studimit si dhe për përmirësime të syllabuseve të lëndëve të veçanta duke i lidhur ato sa më mirë me praktikën aktuale të zhvillimit të biznesve sidomos për bizneset e mesme dhe bizneset e mdha.			
Konkluzione	GVJ ka evidentuar se Fakulteti dhe departamenti që mbulon TOBMSH ka bërë përpjekje për përmirësimin e programit të studimit sipas kërkesave të tregut të punës, ku ka konsultime të herpashërëshme me partnerët, të diplomuarit etj, dhe bazuar në këto konsultime përmirëson programin e studimit, program i cili përshtatet me zhvillimet bashkëkohore të tregut. Kjo gjë arrihet përmes bashkëpunimit me biznese, rrjete profesionistësh, etj të karakterit publik dhe privat.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	Programi realizohet nga njësitë përgjegjëse duke u bazuar në një përvojë të konsiderueshme të transmetimit të dijeve në programe të disa niveleve. Bazuar në këtë përvojë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore, në programin TOBMSH format e përdorura të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e

seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	njohurive janë: leksionet, seminare, ushtrimet, labororet, përfshirja në projekte, leksionet e hapura me ekspertë të fushës, praktikat mësimore dhe profesionale. Ndarja e tyre, e bërë nga GVJ bazuar në planin mësimor sipas Tabelës 10 të rishikuar, është si më poshtë: 1.Leksione – 510 (270+240) orë mësimore 2.Seminare – 90 (75 + 15) orë mësimore 3.Laboratore – 275 (180 + 195) orë mësimore 4.Seanca të praktikave profesionale në auditor – 63 (15 + 48) 5.Praktikë profesionale – 120 (60 + 60) orë mësimore 120 Këtyre orëve ju shtohen këtë vit edhe ato të planifikuara për përgatitjen për provimin e përgjithshëm përfundimtar (Provë finale – 18 orë mësimore), duke dhënë një total prej 1058 orë në auditor (dhe terren).20 ore 1710 studim individual [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] Tabela 10, e rishikuar.
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi përfiton nga eksperiencia institucionale në një numër programesh studimi dhe nga ajo personale akademike dhe profesionale për të gërshtuar metodat klasike të mësimimit me forma alternative të mësimdhënies dhe mënyra të nxitjes së mësimnxënies për këtë program studimi me karakter profesional. Kjo qasje është mbështetur institucionalisht me politika, praktika dhe veprime konkrete, siç dëshmohet nga dokumentat dhe takimet në institucion. Pavarësisht madhësisë së programit, në numër studentësh, ishte lehtësisht i evidentueshëm dhe i vlerësueshëm angazhimi dhe përkushtimi i një pjese të stafit të programit për t’ju përshtatur nevojave dhe diversitetit të studentëve, brenda kufizimeve që imponon programi i studimit. [Evidenca A.1.13, Udhëzues për Metodatat e Mësimdhënies] [Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie]
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të	Kujdesi dhe angazhimi i UniBa për rritjen e nivelit të mësimdhënies, vlerësimit të mësimnxënies dhe mbështetjes së studentëve në përshtatje me nevojat e diferencuara të tyre evidentohet përmes dokumentacionit në dispozicion, komunikimit me stafin e programit dhe njësi të tjera përgjegjëse për aftësimin dhe avancimin e stafit në aspektin didaktik, pedagogjik dhe shkencor. Edhe në këtë aspekt, realizimi i programit TOBMSH

të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	përfiton si nga kapacitetet akademike e shkencore brenda DESF, edhe nga kontributi i disa njësive kryesore dhe bazë (fakultete dhe departamente brenda UniBa). <i>[Evidenca A.1.13, Udhëzues për Metodatat e Mësimdhënies],</i> <i>[Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie]</i> <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit në UniBa]</i> <i>[Evidenca A.2.5, Raport Vjetor për Kërkimin Shkencor në Departament, 2022-2023]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit në vitin aktual, por edhe në dy vitet e mëparshme akademike është realizuar me angazhimin e një numri pedagogësh me përvoja akademike e shkencore, të kombinuar edhe me asistent-lektorë kryesisht për zhvillimin e seminareve dhe trajnimeve praktike. Këtë e dëshmon plani mësimor i lidhur me programin e studimit (Tabela 12) dhe CV e stafit akademik të programit (Evidenca A.3.11). Në këtë mënyrë institucioni ka mundur përcjelljen në auditor të njohurive e praktikave të mira, për të nxitur te studentët aftësitë krijuese dhe mendimin kritik. Këtë evidentim e përforcon opinioni i shprehur gjatë takimit nga studentët e programit për një numër lëndësh dhe modulesh që ata kanë zhvilluar në periudhën 2022-2024, ku ata bëjnë dallimin ndërmjet cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura nga pedagogë të ndryshëm. Do të ishte në dobi të programit, por edhe të institucionit në tërësi, vlerësimi public i praktikave të mira (jo vetëm në formën e suportit financiar) dhe përhapja e përvojës në rreth më të gjerë brenda institucionit. <i>[Evidenca A.3.11, CV e stafit akademik të programit të studimit].</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 12]</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Departamenti përgjegjës për programin e studimit TOBMSH ushtron funksionin e tij për të vlerësuar mënyrën e realizimit të programit përmes kontrolleve të procesit, vlerësimeve paralele (koleg me koleg) të anëtarëve, mbledhjes së informacionit me rrugë direkte dhe indirekte nga njësi të dedikuara për sigurimin e cilësisë, si NJZHKC dhe raportimit në nivel hierarkik për këto çështje. Përvoja institucionale i ofrohet programit të studimit dhe njëkohësisht i përshtatet programit duke tërhequr mendimin e studentëve të tij nëpërmjet anketimit për lëndët e këtij programi studimi. Kjo dëshmohej nga formulari i vlerësimit të studentëve për lëndët, i plotësuar në semestrin e parë të vitit aktual akademik që u vendos në dispozicion të GVJ. Përpunimi i pyetësorëve, sipas

	konfirmimit nga strukturat përkatëse, do të mundësojë sjelljen e rekomandimeve dhe masave për përmirësim në periudhat e mëpasme. [Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën] – i vënë në dispozicion pas kërkesës së GVJ			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe të Cilësisë, përmendur edhe në standardet më lart, janë struktura të posaçme që UniBa ka ngritur dhe ushtrojnë funksionet e zbatojnë detyrat e tyre për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke koordinuar dhe bashkërenduar punën me njësitë kryesore/bazë. Raporti vjetor i institucionit dhe raporti për vlerësimin e cilësisë në UniBa ilustron nivelin e angazhimit dhe trajtimin e gjetjeve nga puna për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në institucion. Në mbështetje të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja, për personelin akademik organizohen trajnime nga stafi brenda dhe nga lektorë të ftuar në institucion, stimulohet kualifikimi shkencor dhe pjesëmarrja e personelit akademik në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Përpjekjet dhe arritjet në këtë drejtim janë të drejtpërdrejta kryesisht në nivel institucional dhe reflektohen indirect edhe në programin profesional në vlerësim. [Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023], [Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.36, Lista e Konferencave, Trajnimeve dhe Workshop-eve], [Evidenca A.1.37, Promovim i shembujve të Praktikave të mira]			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit TOBMSH realizohet nga njësitë përgjegjëse duke u bazuar në një përvojë të konsiderueshme të transmetimit të dijeve në programe të disa niveleve. Pëdoren metodat klasike të mësimin dhe forma alternative të mësimdhënies, si dhe mënyra të nxitjes së mësimnxënies për këtë program studimi me karakter profesional. Departamenti dhe njësitë përgjegjëse për cilësinë realizojnë vlerësimin dhe marrin masa për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Duke qenë një proces i vazhdueshëm, ka akoma vend dhe mundësi për përmirësimin e mësimdhënies në programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kuadri rregullator i UniBa ka shërbyer si bazë për hartimin e akteve rregullative të posaçme për programin e studimit TOBMSH, ose që i shërbejnë edhe këtij programi. Këtu përfshihet Rregullorja e programit të studimit ku zenë vend kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentit, dhe akte të tjera që kontribuojnë në mbarëvajtjen e programit. Këto akte rregullative bëhen publike dhe përmbajtja e roli i tyre ju sqarohen studentëve në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi dhe koordinatori i departamentit, si dhe gjatë vitit akademik sipas nevojës ose kërkesave që paraqiten. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMsh]</i> <i>[Evidenca A.2.3, Vendim i emërimit në detyrë të koordinatorit të DESF]</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe nga takimet në institucion konfirmohet që syllabuset e lëndëve kanë të përcaktuar metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, duke specifikuar komponentët përbërës. Ky informacion i vihet në dispozicion studentëve nga pedagogët e lëndëve dhe ju sqarohet hollësisht në orët e para të zhvillimit të lëndës/ modulit. Sic theksohet në RVB dhe u konfirmua gjatë vizitës, raportet ndërmjet komponentëve të vlerësimit variojnë dhe i përshtaten tipologjisë së lëndës. Në të gjitha rastet zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMsh]</i> <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë	Institucioni lejon dhe nxit përdorimin e formave dhe mënyrave të ndryshme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, duke mundësuar që studentët të testohen në mënyrë gjithëpërfshirëse për njohuritë, afësitë dhe kompetencat e përfituara. Edhe në programin TOBMSH vlerësimi i njohurive është i shtrirë gjatë gjithë semestrit dhe realizohet përmes kontrollit të vazhdueshëm dhe pjesëmarrjes aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme, detyra kursi dhe provimit të ndërmjetëm. Ai kombinohet me vlerësimin përfundimtar të njohurive në provimin përfundimtar



praktike.	të lëndës. Edhe vlerësimi i trajnimeve praktike është i përcaktuar dhe i përshtatet natyrës së kësaj veprimtarie, që kombinon vlerësimin nga pedagogu përgjegjës dhe nga personi përgjegjës në institucionin pritës. [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]			
Konkluzione	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale bazohet në akte rregullatore dhe ndjek procedura të përcaktuara, të bëra publike dhe të zbatueshme në këtë program studimi. Format dhe mënyrat janë të larmishme, për t'ju përshtatur nevojës për vlerësim gjithëpërfshirës të studnetëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive të studentit është i përcaktuar dhe i shprehur në syllabusin e secilës lëndë/ modul. Komponentët e vlerësimit variojnë sipas natyrës së lëndës dhe llojit të veprimtarisë, duke orientuar lëndët me karakter praktik nga detyrat dhe punët individuale ose në grup, sipas konfirmimit nga pedagogët dhe studentët në takimet në institucion. Provmi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar janë komponentë të vlerësimit për të gjitha lëndët e këtij programi. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe ai përfundimtar bashkohen duke rezultuar në një total pikësh, që kthehet në notë, sipas përcaktimeve të shprehura qartë në rregulloret dhe programet lëndore. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin	Nuk u evidentuan forma apo sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit në këtë program.

transparencën.	
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Kuadri rregullator i institucionit dhe i programit të studimit përcakton mënyrën e realizimit të provimit përfundimtar të lëndës bazuar në formate standarde të testimit që vihen në dispozicion të stafit akademik nga koordinatori i departamentit. Provimet e lëndëve zhvillohen me shkrim, bazuar në tezat e përgatitura nga pedagogët përkatës. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.3.13, Vendim Rektorati, Nr. 94 dt. 12.02.2021 “Për miratimin e formatit të provimeve, etj”]</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet nga pedagogu/ pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Gjatë vlerësimit të vazhduar studentëve ju jepen sqarime për rezultatet e arritura në provimin e ndërmjetëm apo detyrat e zhvilluara, me qëllim që të përmirësohen në vijim të lëndës. Përpara zhvillimit të provimit përfundimtar studentëve ju mundësohen konsultime ose seanca përmbledhëse mbi njohuritë për të cilat do testohen, e konfirmuar kjo nga studentët e programit. Sipas akteve rregullative, pas vlerësimit të provimit përfundimtar studentët e interesuar mund të njihen me hollësitë e vlerësimit në provim, në mënyrë që të mund të përmirësohen në të ardhmen. Nga takimi me studentët nuk u konstatuan përvoja të tilla. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Aktet rregullative të institucionit përcaktojnë kopjimin, plagjiaturën dhe paraqitjen si punë e vet e punës së një tjetri; dhënien ose marrjen e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit. si veprime që çenojnë normat shoqërore dhe etiko-morale. Për të shmangur këto veprime njësitë përgjegjëse, departamenti dhe sekretaria mësimore marrin masa si: monitorojnë sallën e provimit, bëjnë sekretimin e tezave, ndalojnë përdorimin e telefonave celularë, etj. Në rast shkeljesh të tilla parashikohet aplikimi i masave disiplinore. UniBa ka hartuar Kodin e Etikës, ku krahas të tjerave parashikohet edhe shmangia e plagjiaturës. <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>

	<i>[Evidenca A.1.5, Kodi i Etikës i UniBa]</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i provimeve bëhet nga pedagogu/ pedagogët që kanë zhvilluar lëndën dhe respekton parimet e paanshmërisë dhe meritës. Rezultatet dokumentohen në procesverbalin e vlerësimit semestral/ vjetor dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/ vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e provimit. Vlerësimet ju komunikohen studentëve nga sekretaria e UniBa. Mungesa e një sistemi funksional të menaxhimit të studentëve shton ngarkesën e sekretarisë dhe shkakton vonesa në pasqyrimin e rezultateve në formë elektronike, siç u evidentua nga takimi në sekretari. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe bërja e kërkesës për rishikim të vlerësimit ju mundësohet atyre në takimet që organizohen pas realizimit të provimit dhe vlerësimit, në kohë të caktuar (5 ditë pas zhvillimit të provimit), në përshtatje me kalendarin e provimeve. Studenti ka të drejtë të kontaktojë pedagogun e modulit dhe të diskutojë për vlerësimin dhe mundësinë e ndryshimit të rezultatit. Studentët e programit ishin në dijeni të kësaj të drejte të tyre, por nuk kishin patur rast ta përdorin. <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH].</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	E drejta e ankimimit për vlerësimin e marrë i njihet studentit bazuar në aktet rregullative; gjithashtu ka rregulla të përcaktuara për trajtimin e kërkesës. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të lëndës/ modulit, por para shënimit të notës në Regjistrin e Arritjeve Akademike. Përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin, i cili brenda 48 orësh ngre një komision <i>ad hoc</i> për shqyrtimin e ankesës. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e tij me komisionin e miratuar nga dekan.

	[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti].			
Konkluzione	Procesi i vlerësimit të studentëve për njohuritë dhe aftësitë e përfituara bëhet i kombinuar, i vazhdueshëm dhe me provimin përfundimtar, ndjek procedura të mirëpërcaktuara, bazohet në meritën dhe mundëson transparencë. GVJ gjykon se ka vend për përmirësim në elementë teknikë që lidhen me procesin në pjesën e punës së sekretarisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Pajisja e studentëve me njohuritë dhe kompetencat kryesore të domosdoshme për karrierë profesionale në operacionet e biznesit, marketing dhe shitje përbën qëllimin e përfshirjes në program të lëndëve të formimit bazë dhe karakterizuese për programin, pas ndryshimeve në masën 20%. Njohuritë e fushës së marketingut dhe shitjes jepen në program nëpërmjet një numri lëndësh dhe garantojnë aftësimin e studentëve në këto fusha. Edhe trajnimet praktike në të dy vitet theksojnë përvetësimin dhe aplikimin e njohurive në këto fusha. Njohuritë e fushës së menaxhimit të organizatës, operacioneve, burimeve njerëzore, logjistikës, zenë më pak vend në program dhe përgjithësisht i takojnë lëndëve bazë ose ndërdisiplinore (A dhe C). Në tërësi, programi siguron njohuri dhe aftësi profesionale që ju nevojiten studentëve për punësimin e tyre të ardhshëm, që mund të rishikohen pas diplomimit të brezave që po formohen me këtë plan mësimor të ndryshuar. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit është mbajtur parasysh me kujdes në program dhe një numër lëndësh, bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore jua mundësojnë studentëve këtë zhvillim. Teknologjia e informacionit qëndron në themel të lëndëve dhe moduleve si “TIK në shkolla dhe shoqëri” (që mund t’ju paraprijë

	të tjerave të fushës), “Bazat e Programimit në Marketing”, “Njohuri Programimi për shitjet On-line”, “Marketingu Dixhital”, “Sisteme informacioni për marketing”, etj. Edhe mënyra e zhvillimit të këtyre lëndëve, sipas përshkrimit në syllabuse garanton përfitimin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme. Njohuritë nga fusha sociale, komunikimi dhe ndërveprimi gjithashtu ofrohen në një numër lëndësh, duke mundësuar aftësimin e studnetëve në përputhje me kërkesat në rritje për këtë gamë njohurish e kompetencash. “Puna në Grup dhe Komunikimi”, “Etika në Grup dhe Komunikimi”, “Etika në biznes”, etj., plotësojnë mirë kërkesat për soft skills të punonjësve të ardhshëm në tregun e punës. Sa i takon emërtimeve, përmbajtjes së këtyre lëndëve dhe literaturës bazë të përfshirë në syllabuset e tyre, gjykojmë se ka vend për përmirësim. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Zhvillimi i secilës lëndë/ modul ofron një masë njohurish që në përfundim të semestrit duhet të garantojë përvetësimin e koncepteve dhe arritjen e objektivave formues. Nga përshkrimi në RVB dhe takimet në institucion konfirmohet se në përfundim të lëndës/ modulit pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, sqarojnë përmbajtjen mbi të cilën do të ndërtohet testi përmbledhës dhe orientojnë studentët për pyetjet në testim, nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe pjesët e programit që përfaqësojnë, kohën e testit dhe mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve. Rezultatet e provimeve janë një tregues i efektivitetit të përpjekjeve të kombinuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga pedagogët dhe studentët. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të	Metodat e mësimdhënies që përdoren në këtë program profesional nxisin zhvillimin e kompetencave të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme në mjediset e punës ku studentët zhvillojnë praktikën dhe ku mund të punësohen pas diplomimit. Nxitja e punës në grup, analizës dhe mendimit krijues për zgjidhjen e problemeve, brenda kuadrit të kompetencave dhe vendimmarrjes që i takon programit, janë element të konfirmuar nga pedagogët dhe studentët gjatë takimeve. Praktika profesionale e zhvilluar në çdo semestër në një ose disa institucione ose në institucionin ku studentët janë të punësuar rrit mundësitë për përdorimin në kushte reale të aftësive të përfituara. [Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për programet profesionale,

caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	2022-23] [Evidenca A.3.9. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit] [Evidenca A.3.9.1, Relacion i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit]			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Praktika e mirë e UniBa për realizimin e leksioneve të hapura dhe seminareve për zhvillime reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë, me pjesëmarrjen e profesionistëve të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë programit dëshmohej nga dokumentacioni i paraqitur dhe u përshkrua nga personeli akademik gjatë vizitës. Evidentohet përfshirja e lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor, si element i rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies, duke patur të ftuar të spikatur nga fusha të ndryshme. Procesi planifikohet dhe organizohet rregullisht duke u dhënë mundësinë edhe studentëve të këtij programi të njihen me profesionistë të fushave të ndryshme. [Evidenca A.2.4, Analizë vjetore e punës së DESF, 2022-2023] [Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i Studentëve 2023-2024]			
Konkluzione	GVJ konstaton se në tërësi, programi siguron njohuri dhe aftësi profesionale që ju nevojiten studentëve për punësimin e tyre të ardhshëm në fushat e programit. Programi i pajis studentët edhe me aftësi e kompetenca të teknologjisë së informacionit, sociale e të komunikimit. Megjithatë, sa i takon emërtimeve, përmbajtjes së këtyre lëndëve dhe literaturës bazë të përfshirë në syllabuset e tyre, gjykojmë se ka vend për përmirësim. Metodot e përdorura mundësojnë shtimin e njohurive dhe aftësimin për ti përdorur ato në praktikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Aktet rregullatore të institucionit përcaktojnë kushtet dhe procedurat për përmbylljen e studimeve të programeve që ofrohen. Për programin TOBMSH, pas ndryshimeve në planin

realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	mësimor në masën 20%, është vendosur që studimet të përmbyllen me provën finale, në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Paraprakisht studenti duhet të ketë përfituar të gjitha kreditet e lëndëve dhe moduleve të të dy viteve (114 ECTS) që të paraqitet në provimin përfundimtar ku fiton 6 ECTS dhe plotëson totalin prej 120 ECTS. Ky detyrim pasqyrohet në planin mësimor. [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)] [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	I takon DESF të hartojë programin e provimit të formimit dhe të angazhojë personelin akademik për të orientuar studentët për njohuritë që do të përfshihen, materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale duke organizuar edhe konsultimet e nevojshme. Përvoja institucionale nga programe të tjera do të ndihmojë edhe këtë program që të arrijë qëllimet e mirëpërcaktuara që një program orientues ka: (i) lehtësimi i punës individuale të studentit për të rifreskuar njohuritë teorike të marra përgjatë programit të studimit; dhe (ii) lehtësimi i inventarizimit të literaturës përkatëse, e cila do të përdoret për përgatitjen e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Duke qenë viti i parë i aplikimit të kësaj procedure përmbyllëse për programin TOBMSH, janë të kuptueshme paqartësitë lidhur me këtë program orientues dhe detyrim të studentët e vitit të dytë. [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Përmbajtja e programit të provimit të formimit duhet të sigurojë përfshirjen në testimin përfundimtar të njohurive kryesore të marra përgjatë 2 viteve akademike që formësojnë profesionistin e diplomuar në programin TOBMSH. Nga komunikimi me drejtuesit e njësive përgjegjëse për programin e studimit u evidentua se është qartësuar si do procedohet për provimin përfundimtar, mbi mënyrën e zhvillimit (me shkrim dhe me gojë), përmbajtjen e pyetjeve dhe komisionin e provimit të përbërë nga tre anëtarë. Përvoja institucionale nga programe të tjera do të ndihmojë edhe në këtë drejtim. [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.

përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, teste në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Në rastet kur studentëve ju nevojiten matje, analizave, teste në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temës/ temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit, institucioni ndihmon, nëpërmjet një pedagogu të caktuar ose pedagogut mentor të praktikës. Nga takimet nuk u evidentuan raste të tilla.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Procedura e diplomimit bazuar në aktet rregullatore institucionale dhe në rregulloren e programit të studimit përcakton që studenti në provimin final vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Përfundimi i studimeve në këtë program ju jep mundësi studentëve të pajisen me “Diplomë Profesionale” në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, me kërkesë të studentit, mund t'i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.3.7, Formati i diplomës TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.3.7.2, Vërtetim nga QSHA për dokumentin që shoqëron diplomën].</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për	Në përputhje me legjislacionin në fuqi një kopje e dokumentacionit të secilit student mbahet në arkivin e sekretarisë së UniBa për një periudhë të pacaktuar dhe është i aksesueshëm sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në

studentin nëse kërkohen.	lidhje me studentët. <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funksonimin e Sekretarisë Mësimore]</i>			
Konkluzione	Studimet në programin TOBMSH përmbyllen me provim përfundimtar. Aktet rregullatore institucionale përcaktojnë kriteret dhe procedurat për përgatitjen, realizimin, vlerësimin dhe evidentimin e rezultateve të detyrimeve përmbyllëse. GVJ rekomandon që përvoja e programeve të tjerë të UniBa të aplikohet edhe në programin TOBMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Garantimi dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies mundësohet nga strukturat e ngritura pranë UniBa dhe mbështetet me akte të brendshme rregullatore. Institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional: - për zhvillimin dhe përdorimin e infrastrukturës së TIK, në të cilin është investuar sidomos në kampusin e ri, - për metodat e mësimdhënies në mënyrë që pedagogët të krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative të studentëve. Gjithashtu zbaton politika nxitëse për stafin dhe studentët që të bashkëpunojnë, zhvillojnë ide e t'i bëjnë ato të zbatueshme përmes projekteve apo në mjediset e institucionit të dedikuara për inovacionin. Pedagogët krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative të studentëve. Stafi inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së TIK]</i> <i>[Evidenca A.1.13, Udhëzues për Metodatat e Mësimdhënies]</i> <i>[Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe</i>

	<i>cilësinë në mësimdhënie/</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Strukturat përgjegjëse për cilësinë, në bashkëpunim me fakultetet dhe departamentet kanë zhvilluar mekanizma dhe, monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e mësimdhënies. Burimet kryesore të të dhënave, përshkruar në RVB dhe konfirmuar gjatë takimeve me grupet përkatëse, janë ato të mbledhura nga stafi akademik përmes vlerësimit kolegj me koleg, nga njësitë bazë e kryesore përmes vlerësimit në linjë hierarkike, nga studentët, përmes pyetësorëve dhe focus grupeve dhe nga stafi administrativ. Përpunimi i të dhënave, pavarësisht kohës së konsiderueshme që kërkon, sipas konfirmimit nga njësitë e përfshira, lejon që mbi bazën e tyre të gjykohej për nevojën për përmirësim të proceseve mësimore dhe atyre administrative. Praktika në tërësi është e vlerësueshme. <i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së]</i> <i>[Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegj me koleg]</i> <i>[Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën]</i>
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit përcillen në strukturat dhe njësitë përgjegjëse për të mundur marrjen e masave të nevojshme. Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë që janë Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë i bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Analizat në nivel njësie kryesore dhe bazë, paraqitja e rezultateve të vlerësimit shumëdimensional dhe prezantimi i praktikave të mira janë instrumenta që stimulojnë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Ato plotësohen me masa konkrete si p.sh nëpërmjet financimit të pjesëmarrjes së personelit në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore dhe projekte. Nga takimet u evidentuan anëtarë të personelit të përfshirë në këto procese. <i>[Evidenca A.1.37, Promovim i shembujve të praktikave të mira]</i> <i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (Viti Akademik 2022-2023)]</i>
Konkluzione	GVJ konstaton dhe vlerëson faktin se garantimi dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies mundësohet nga strukturat e ngritura pranë UniBa dhe mbështetet me akte të brendshme rregullatore.

Handwritten signatures

	<i>Instrumentat që përdoren, evidentimi i gjetjeve dhe publikimi i tyre kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së proceseve institucionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga dokumentacioni dhe nga të dhënat që marrëm nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore vihet re se bëhet një punë e kënaqëshme për rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me politikat e organizatës dhe legjislacionin në fuqi dhe mirëfunksionimin e tij dhe gjithashtu ka rregulla të përcaktuara dhe procedura institucionale që së bashku me aktet e brendshme rregullatore bëjnë të mundur punësimin e një stafi i cili vjen në përmirësim të vazhdueshëm. Bazuar në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, UniBa ha hartuar dhe ndjek një politikë transparente për punësimin dhe rekrutimet e reja. Rekrutimi i personelit akademik përpunohet të gjejë burime sa më cilësore dhe bazohet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, gradat/ titujt shkencorë dhe aktivitetin kërkimor shkencor e botues të personelit dhe të të rekrutuarve të rinj, gjë që është në përputhje me politikat e UniBa dhe legjislacionin në fuqi. Procesi i rekrutimit bëhet çdo fillim semestri apo viti dhe fillon me evidentimin e nevojave sipas njësive bazë dhe kryesore. Kërkesat grumbullohen pranë ZMBNj, e cila publikon shpalljen për vendet e lira të punës duke specifikuar edhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë, krurere që vendosen në

	bashkëpunimim me departamentin dhe drejtuesit e tjerë të UniBA. Shpallja dhe dokumentacioni i kërkuar bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa-s, që janë të aksesuesme nga të interesuarit. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit me karakter profesional TOBMSH, përzgjidhet që të plotësoj sa më mirë kërkesat ligjore. Një pjesë e mirë e personelit të angazhuar në këtë program studimit është if mirëkualifikuar me grada dhe tituj shkencor dhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Kualifikimet dhe eksperiencat e tyre profesionale janë të përshatura sipas modulit në të cilin ata angazhohen: https://umb.edu.al/news5146.html <i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Permbledhese per RVB]</i> <i>[Evidenca A.3.11, CV e Stafit Akademik të programit të studimit]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në kornizën ligjore në fuqi, personeli akademik I brendshëm i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës mbulon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore për këtë program studimi, në raportin 11 PAE/ 2 PAK (gjatë vitit akademik 2023-2024). Personeli akademik efektiv i angazhuar mban grada dhe tituj si vijon: nga 1 professor i asociuar, 3 persona me grade shkencore Dr., 7 MSc. Personeli me kontratë përbëhet nga 1 Dr dhe 1 Msc. Për vitin akademik 2022-2023 raporti PAE / PAK ka qenë 11/1, me grada dhe tituj përkatësisht: 1 professor i asociuar, 1 Dr., 9 Msc 1 Msc personel me kontratë. Në fillim të vitit akademik, Rektori dërgon periodikisht udhëzime në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore, vit pas viti. <i>[Evidenca A.1.16, Udhëzim lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 6.2]</i> <i>[Evidenca 6 sipas listës së dokumentave shtesë të kërkuara nga GVJ]</i>

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në të dhënat e marra nga ZMBNJ dhe nga takimi me pedagogët vihet re se për të gjithë periudhën e akreditimit të programit të studimit, ka patur dhe ka qëndrueshmëri të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu u vu re përpjekjet e vazhdueshme të stafit për ngritjen e tyre akademike dhe shkencore. https://umb.edu.al/news5146.html https://umb.edu.al/news5147.html [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB] [Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit]
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet e organizuara vumë re se në UniBa aplikohen procedura rekrutimi dhe vlerësimi, që janë të mbështetura në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe transparente dhe që ofrojnë mundësinë për përzgjedhjen e personelit me nivel sa më të mirë kualifikimi duke u përshatur me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.¹ Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertizën akademike dhe kërkimore të pedagogut, si edhe përvojës në fushën e mësimdhënies. Niveli i kualifikimit të personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi tenton të jetë sa më shumë në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit duke kombinuar staf me natyrë teorike dhe praktike. [Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore] [Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit] [Evidenca A.3.11, CV e Stafit Akademik të programit të studimit]
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në faktin se ky është një program 2 vjeçar me fokus praktik vumë re se janë të angazhuar personel ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve të ushtrimeve, laboratorëve, etj. Personeli administrativ, akademik dhe ndihmës akademik është gjithmonë sa më pranë studentëve dhe në shërbim të përgatitjes së tyre për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. Kjo gjë u vu re edhe nga takimi i organizuar me studentët. Mbas zhvendosjes në kampusin e ri të UniBa janë kryer ndryshimet e nevojshme dhe tashmë institucioni ka zyra përgjegjëse, që merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të

¹ <https://umb.edu.al/news5146.html>
<https://umb.edu.al/news5147.html>

	programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore siç janë laboratorët e City Lab, që përfshijnë një shumëllojshmëri laboratorësh mësimorë si: laborator i sigurisë dhe emergjencave natyrore, efikasiteti së energjisë, ndryshimeve klimatike etj. Të cilat në disa raste ju shërbejnë edhe studentëve të TOBMSH
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Në strukturën e UniBa funksionon Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore që është njësi përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme), ndihmës mësimor-kërkimor dhe administrativ, të angazhuar në nivel institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i> <i>[Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit]</i> Të gjithë personelin sipas kategorive përfshijnë dokumentat standard të aprovuara nga UniBa ku për çdo anëtar të stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme dhe për stafin ndihmës akademik dhe administrativ ekziston një dosje e cila është e plotësuar sipas kësaj kërkesave. Gjatë vizitës sonë konstatuam se këto dosje mbaheshin me rregullsi.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Duke qenë se program është program profesional 2 vjeçar, për studentët e TOBMSH universiteti e ka bazuar këtë program në realizimin e praktikave mësimore të rregullta. Për këtë qëllim studentët kanë në dispozicion personel akademik që kryen mentorimin dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale, e cila bazuar në detyrimet akademike kryhet pranë institucioneve të ndryshme publike ose jopublike. UniBa ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani private dhe institucione shtetërore, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve për zhvillimin e praktikave në këto institucione. Këto marrëveshje janë në rang universiteti dhe ashtu edhe si për studentët e tjerë përshijnë edhe studentët e TOBMSH. Mbikëqyrja e studentëve në praktikë bëhet nga stafi akademik që ndjekin praktikën dhe kryejnë vlerësimin e studentëve sipas rregullave të përcaktuara nga universiteti. UniBa ka të arkivuara marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit dhe korrespondencën e vazhdueshme me partnerët në përfundim të kryerjes së praktikës

	nga ana e studentit <i>[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për Programet me karakter Profesional]</i> .			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli akademik mbikëqyr studentët për të parë kushtet e punës në të cilat ata zhvillojnë praktikën mësimore, mënyra e organizimit, niveli i angazhimit të studentëve etj Në fund të praktikës mësimore studentët që zakonisht i kanë përmbushur detyrimet e praktikës, hartojnë raportin përfundimtar të praktikës si janë aktivë në procesin e vlerësimit që atyre u bëhet për praktikën profesionale. <i>[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për Programet me karakter Profesional]</i> <i>[Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]</i> <i>[Evidenca A.3.9.1, Përfutimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se personeli akademik dhe ndihmës akademik i programit TOBMSH përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe mbulon ngarkesën mësimore duke patur qëndrueshmëri personeli të cilët kanë kontrata pune dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Rekrutimi dhe vlerësimi kanë procedura standard me kriteret të përgjithshme dhe specifike duke realizuar përzgjedhjen e duhur të personelit. Në programin TOBMSH angazhohet edhe persone ndihmës akademik për të ndihmuar në punë dhe në praktikën mësimore. UniBa ka një system të rregullt të të dhënave të personelit të angazhuar. Praktika profesionale realizohet bazuar në marrëveshje dhe studentët plotësojnë rregullisht detyrimet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve,	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si edhe nga vizita në institucion vumë re se UniBa ka përmirësuar të gjithë kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies, praktikës profesionale, trajnimeve dhe çdo nevojë apo kërkesë tjetër të studentëve në lidhje me ambientin.

grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Kampusi i ri i UniBa është një arritje e vlerësueshme për përmirësimin e infrastrukturës në ndohmë të studentëve. Gjithashtu theksojmë se UniBa ka krijuar mjedise komode dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, bazuar në profilin e punës së secilit punonjës. Kapacitetet infrastrukturore të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë akademike të programit janë të përshtatshme për funksionin e tyre dhe I përmbushin parametrat e nevojshëm. <i>[Evidenca A.1.39, Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa]</i> <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit].</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në UniBa vumë re se të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat mbështesin mësimdhënien dhe garantojnë realizimin cilësor të procesit mësimor. Nga stafi përkatës na u konfirmua se një ndër objektivat kryesorë strategjike të UniBa është dixhitalizimi. Në kampusin e ri të UniBa të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi dixhital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video. Në funksion të dixhitalizimit i gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet WiFi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner, etj., në zyrat e stafit akademik dhe atij administrative <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i> dhe <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit].</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës vumë re se mjediset e punës për pedagogët dhe studentët janë të personalizuar dhe të specializuara sipas llojit dhe profilit të degëve, drejtimeve apo moduleve që zhvillohen. Ne pamë mjediset e punës të studentëve të TOBMSH. Mjediset disponojnë ambientin dhe mjetet e domosdoshme të zhvillimit cilësor të mësimdhënies dhe mësim nxënies bazuar në standardet e vendosura nga UniBa. Mjediset, që janë në funksion të programit të studimit TOBMSH, ofrojnë facilitetet e nevojshme për mundësimin e aspektit praktik dhe stimulues për studentet. <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i> <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion theksojmë se në

të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	njërën nga godinat e kampusit në rrugën 'Frang Bardhi' janë 12 salla për leksione me sipërfaqe 932.15 m² dhe 6 klasa për seminare me sipërfaqe 221.29 m². Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale. Sallat për praktikë profesionale janë 2 me sipërfaqe 19.46 m² dhe laboratorët e informatikës në dispozicion 3 me një sipërfaqe prej 148.22 m²; 25 poste në salla interneti (përbashkët) me sipërfaqe 1419.67 m². [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16] [Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]			
Konkluzione	Bazuar në punën e bërë GVJ konstatoi se UniBa ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, dhe këto mjedise janë të pajisura me mjetet e teknologjisë së informacionit duke realizuar procesin mësimor përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore. Laboratorët, janë të paisura me mjetet e nevojshme për realizimin e moduleve. Gjithashtu ka laboratore të pajisur me programe profesionale pune për TOBMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Programet lëndore të programit TOBMSH kanë të përcaktuar literaturën bazë dhe ndihmëse të nevojshme që studentët të përvetësojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat në fushat e programit të studimit, marketing, shitje dhe operacionet e biznesit. Për një pjesë të lëndëve literatura bazë e përcaktuar në syllabuse është në gjuhën e programit në formën e teksteve universitare. Për shkak të natyrës së programit, siç u konfirmua nga personeli akademik i angazhuar, ka vështirësi në gjetjen e literaturës në gjuhën e programit, prandaj për pjesën tjetër të lëndëve ofrohen leksione të përgatitura nga pedagogët bazuar në literaturën në gjuhë të huaj. Ato ju vihen në dispozicion studentëve në formë

	fizike ose digjitale. Përpjekjet e personelit akademik për t'ju ofruar studentëve literaturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për lëndët në këtë program studimi janë të vlerësueshme. [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] [Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Studentët e programit kanë akses të lirë dhe të barabartë në bibliotekë. Nga vizita në bibliotekë u evidentuan tituj librash në fushat e programit të studimit të botuar në vitet e mëparshme, por edhe botimet më të fundit (në menaxhim, marketing, menaxhim i operacioneve, etj.). Disa prej tyre janë të përfshirë si literaturë bazë në syllabuset e këtij programi, ndërsa disa të tjerë do të ishte e rekomandueshme të përfshihen, duke zëvendësuar botime më të hershme, jo të përditësuara që rekomandohen në disa programe lëndore. Gjithashtu institucioni ka krijuar platformën e bibliotekës online që ju shërben dhe aksesohet nga përdoruesit edhe në distancë, përgjithësisht pedagogët e lëndëve. [Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Pajisja e bibliotekës së institucionit me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, libra apo revista shkencore përshkruhet në RVB dhe u konfirmua gjatë vizitës. Dokumentacioni dhe gjendja fizike e botimeve më të reja të fushës ekonomike në raftet e bibliotekës dëshmojnë për pasurimin periodik të fondit të bibliotekës. Në komunikim me personat përgjegjës u konfirmua mënyra e funksionimit të bibliotekës në shërbim të studentëve, kryesisht e lidhur me librat e nevojshëm e të mjaftueshëm për programin e studimit. Sa i takon leksioneve të përgatitura nga pedagogët e lëndëve, ato nuk depozitohen në bibliotekë, por ju përcillen drejtpërdrejt studentëve. [Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së	Bazuar në evidencat dhe nga vizita në mjediset e bibliotekës u qartësua që bibliotekat online që institucioni disponon dhe që lidhen me fushën e programit të studimit shfrytëzohen pa pagesë nga personeli akademik. Institucioni ka mundur menaxhimin e librave të bibliotekës

programit të studimit.	nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili lehtëson dhe përshpejton gjetjen e librave sipas kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/ kthimin, vonesat, humbjen apo dëmtimin e librave. [Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës] [Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Biblioteka e UniBa, e vendosur në disa ambiente të kampusit të ri, i shërben studentëve të programit me mjediset e saj të dhe të pajisura në një masë të caktuar me mjete e programe kompjuterike për përdorim komod nga ana e studentëve. Kujdesi i institucionit për investime të vazhdueshme dhe pasurimin e fondit fizik dhe digjital të bibliotekës është i vlerësueshëm, pavarësisht masës relativisht të ulët të shfrytëzimit të këtyre aseteve nga ana e studentëve të programit në vlerësim. [Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	UniBa e ka vënë bibliotekën në dispozicion të studentëve për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.00 – 19.45. Brenda fashës orare 08.30-16.30 stafi akademik, studentët, stafi jo akademik mund të bejmë kërkesë dhe të shërbehen me libra. Brenda fashës orare 16.30-19.45 ambientet e bibliotekës mund të përdoren për studim/lexim dhe librat në sallë mund të përdoren për lexim, por nuk bëhet shërbim i librit me vete. Platforma digjitale e menaxhimit të librit mundëson akses në të dhënat e bibliotekës edhe nga jashtë ambienteve të universitetit. https://umb.edu.al/biblioteka.html
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah	Stafi i bibliotekës bashkëpunon me njësitë përgjegjëse për programet e studimit për pasurimin e fondit të librave dhe materialeve të tjera, sipas nevojave dhe kërkesave të lëndëve. Gjithashtu bëhet kujdes për mirëmbajtjen e fondit ekzistues dhe për të nxitur përdorimin e librave fizikë dhe bibliotekave online që institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve, kërkuesve dhe studentëve të vet. [Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës] [Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]

sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.				
Konkluzione	<i>Kujdesi i institucionit për investime të vazhdueshme për krijimin dhe pasurimin e fondit fizik dhe digjital të bibliotekës, për krijimin e kushteve optimale për punën në bibliotekë dhe për aksesimin në distancë, në vecanti për stafin akademik, është i qartë dhe i vlerësueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	UniBa ka ndërtuar dhe ka në funksion një sistem të plotë menaxhimi si për studentët dhe për stafin. Këtu përfshihen sistemi administrativ, pranimi, informacioni, orientimi, këshillimi, mbështetjeje sociale dhe universitare. Në të bëjnë pjesë njësitë e organikës së brendshme si: sekretaria mësimore, zyra e rekrutimit dhe pranimit, dekani i studentëve, klubet studentore si dhe të gjithë stafi administrativ dhe akademik, i cili ofron në vazhdimësi informacion të rëndësishëm e të vlefshëm për studentët dhe i mbështet ata profesionalisht. UniBa disponon platforma të menaxhimit të studenteve, siç është ajo e portalit studentor apo platforma Classroom. Portali studentor është një sistem që kur të jetë në përdorim për studentët do ju mundësojë atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike, me informacione mbi lektorët dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Mbështetja ndaj studentëve nuk është vetëm profesionale dhe akademike por edhe për jetën e tyre sociale dhe për karrierën, pra se si të orientojnë në një treg dinamik dhe strategjik dhe se si të rrisin dhe zhvillojnë kapacitetet dhe aftësitë individuale e të lidërsipit, për të spikatur sa më shpejt në profesion dhe në jetë. <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i>

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UniBa ka në dispozicion një sistem të brendshëm menaxhimi i cili administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, si dhe partnerëve të angazhuar për realizimin e programit. Ky sistem përbëhet nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretaria e Përgjithshme dhe Sekretaritet Mësimore, Bordet e Karrierës pranë Departamenteve, Zyra e Menaxhimit dhe Vlerësimit të Performancës, si dhe Zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve. Sistemi është funksional dhe bën të mundur bashkëpunimin midis njësive në kuadër të funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi funksionale dhe organike, si dhe ndërveprimit me njëra tjetrën. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm është i aksesueshëm në shared, i kategorizuar sipas njësive të ndryshme. Gjithashtu, sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna në dispozicion si edhe me anë të intranetit të monitoruar nën domain të universitetit dhe komunikimi me publikun nëpërmjet website-it zyrtar, mediave sociale, etj. <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit në mënyrën se si është ndërtuar siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Ky sistem është dizenuar në mënyrë të tillë që lejon sistemimin e veprimtarive dhe proceseve të tillë si: përgatitja dhe monitorimi i orareve mësimore, kontratat e punës, formularët e matjes dhe vlerësimit të performancës, formularët dhe programi i ngarkesës mësimore, formulari i evidentimit të masave disiplinore dhe aplikimit për leje vjetore, raporte leje lindje etj. Si në të gjitha sistemet e tilla akses është i dedikuar dhe privatësia garantohej nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në intranet ashtu edhe në platformat online, sipas kategorisë së përdoruesit. <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.26, Rregullore e Protokollit dhe Arkivës]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që, kur kur të jenë në përdorim për studentët, do mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Në UniBa kjo gjë realizohet përmes komunikimit ballë për ballë, në auditor, dhe gjithashtu me anë të sistemit elektronik të komunikimit, ku si për stafin ashtu edhe për studentët janë hapur dhe funksionojnë adresat zyrtare të e-mailit (me domain-in umb.edu.al). UniBa disponon një domain me adresa elektronike për pedagogë

	dhe studentë. Gjithashtu është krijuar një bazë të dhënash elektronike e centralizuar në nivel institucioni, e emërtuar Shared, e cilat siguron integrimin e informacionit. Gjithashtu çdo departament ka një koordinator i cili ndihmon në mbarëvajtjen e komunikimit interaktiv. <i>[Evidenca A.2.3, Urdhri Nr.29, datë 14.10.2022 "Për emërim në detyrë të koordinatorëve të Departamentit të Ekonomise, Sipërmarrjes dhe Financës]</i> <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Vënia në funksion dhe përdorimi i sistemeve të analizuara në kriteret e mësipërme, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët. Përdorimi i teknologjisë në nivele bashkëkohore lejon që këto procese të realizohen në kohë reale dhe ti shërbejnë punës së përditëshme.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Edhe gjatë vizitës ne vumë re se faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të plotësuar në kohë reale, në Shqip dhe Anglisht, dhe rifreskohen sipas nevojave, herë pas here duke mbajtur të përditësuar të gjithë informacionin e duhur mbi programin e studimit, organizimin, funksionimin, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme të institucionit. Ky përditësim bëhet në Rrjetet Sociale: Facebook, Instagram, Twitter: Universiteti Barleti, Trajnime Barleti, Klubet Studentore Barleti, si dhe në web: www.umb.edu.al			
Konkluzione	<i>UniBa ka një sistem të brendëshëm menaxhimi për administrimin e informacionin për studentët, nga regjistrimi deri në diplomim. Ky system administron gjithë informacionin për studentët dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik e administrative. Sistemi ka akses të dedikuar për studentët dhe personelin duke integruar platforma dhe module të komunikimit interaktiv. Sistemi bën të mundur monitorim e aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale për autoritetet drejtuese. Informacionet zakonisht janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UniBa.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Zyra e Financës në UniBa, harton raportet financiare me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimit dhe mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatshkurtra dhe afatmesme. Dokumenti financiar në zyrën e financës mbahej edhe elektronikisht për të menaxhuar sa më mirë informacionet financiare të nevojshme për drejtimin e institucionit dhe njësisë në përbërje të tij. <i>[Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit]</i> <i>[Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.38.1, Raporti financiar vjetor institucional]</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit, sikurse dhe Raporti Financiar Vjetor, përmbajnë të dhënat e nevojshme në mënyrë të plotë dhe të detajuar lidhur me financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative, detyrimet financiare, grantet e ndryshme, etj. për programin e studimit. Raporti Financiar Vjetor, paraqet të dhëna mbi Strategjinë, misionin dhe objektivat, aspektet ekonomike, kurrikulumin, buxhetin sipas zërave dhe viteve, sikurse dhe kontrollin financiar. Rregullsia financiare vihej re edhe në mënyrën e organizimit të njësisë të ndryshme duke patur parasysh investimin në paisjet e domosdoshme dhe në shpenzimet operative që gjërat të funksiononin në mënyrë sa më eficiente. <i>[Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit]</i> <i>[Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.38.1, Raporti financiar vjetor institucional]</i> <i>[Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UniBa ka të organizuar kontrollin dhe auditimin i cili bazohet në legjislationin në fuqi dhe realizohet si vijon: 1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga auditues të caktuar nga aksionerët. Auditimi i Brendshëm i caktuar nga aksionerët e shoqërisë realizon vlerësimin rregullshëm ligjorë

	për veprimtarinë e përditëshme dhe për kontratat, për politikat dhe procedurat. Ai harton Raportin Vjetor të Auditimit të Brendshëm, raport I cili i dërgohet menaxhimit të Universitetit. 2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në UniBa kryhet nga auditues të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave. Pozicioni Financiar i Institucionit dhe veprimtaria financiare e tij auditohen rregullisht çdo vit nga kompania audituese “Grant Thornton” e cila është një kompani auditimi e njohur ndërkombëtarisht. Kjo kompani çertifikon pasqyrat financiare të institucionit që paraqiten për palët e treta dhe organet shtetërore. Raportet e Auditimit të Jashtëm depozitohen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara [Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022]
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga takimet e bëra gjatë vizitës në UniBa na u theksua nga stafi se në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e fundit akademike duke identifikuar dhe planifikuar nevojat për ndërhyrje specifike, për më shumë larmishmëri të financimit të programit dhe për një ecuri sa më rezultative të tij në të ardhmen. Referuar raporteve financiare evidentohet gjithashtu rezultati dhe efekti i financimit të programit të studimit por edhe pritshmëritë e mënyrës së financimit dhe bëhen parashikimet/planet për vijimësinë e tij me qëllim rritjen e standardeve, shoqëruar me interesim dhe përzgjedhje më të lartë të tij nga të interesuarit. Çdo vit treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në bordin e Administrimit [Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022]
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të	Gjatë vizitës dhe nga dokumentacioni në dispozicion na u prezantua fakti se UniBa zotëron të ardhurat e nevojshme financiare për të garantuar stabilitetin e nevojshëm dhe kapacitetet e duhura financiare për të ardhmen. Të ardhurat kryesore të institucionit janë tarifat e studentëve si dhe të ardhura të tjera nga projekte dhe donacione. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, rezulton se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për mbajtjen stabël dhe nën kontroll të situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Gjithashtu në raportin e auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët dhe mundësitë e

programeve të studimeve.	vazhdimësisë stabël në të ardhmen. [Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit] [Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UniBa harton raporte financiar të kostove për njësitë përbërëse dhe për programet (TOBMSH) planin për mbështetjen financiare, plan që përmban të elementët e nevojshëm. UniBa kryen auditim periodik të shpenzimeve deri tek njësitë bazë lidhur me realizimin e buxhetit të miratuar. UniBa ka qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit TOBMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion lejojnë të konfirmojmë se i gjithë procesi nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregullatore institucionale që UniBa ka hartuar e zbaton. Procesi mbështetet edhe me strukturat e ngritura dhe kapacitetet e vëna në dispozicion. Strukturat dhe zyrat përkatëse, përfshirë Zv. Rektorin për Çështjet Studentore, Zyrën e Rekrutimit, Pranimin dhe Regjistrimit, Dekanin e Studentëve, Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, kujdesen për studentët në rrugëtimin e tyre nga hyrja deri në përfundim të studimeve, sipas përgjegjësisë që ju takojnë. [Evidenca A.1.23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa] [Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i studenteve 2023-2024]

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UniBa bën kujdes të ofrojë të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit dhe të garantojë paanësinë e barazinë nëpërmjet politikave dhe procedurave që ka hartuar dhe zbaton. Këto parime evidentohen në paketën e dokumentacionit të institucionit dhe bëhen publike për të gjithë të interesuarit. <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore PP - TOBMSH]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni respekton kërkesat ligjore dhe harton e publikon me mjetet e veta të informimit kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Ky informacion është publik, transparent dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare të UniBa. Ai ju përcillet të interesuarve edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit. <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studenteve]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Krahas informimit mbi kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim në programin e studimeve, që përbën hapin e parë për tu bërë “Barletas”, studentëve dhe publikut të interesuar ju mundësohen edhe informacione mbi zhvillimin e procesit dhe avancimin drejt diplomimit (e përshkruar më lart), si dhe mbi mundësitë dhe procedurat e njohjes dhe transferimit të krediteve. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm përmes faqes zyrtare dhe ofrohet nga ana e zyrave përkatëse të institucionit, në formë të kuptueshme. <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studenteve]</i>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në respekt të kërkesave ligjore dhe përgjegjësisë sociale, UniBa ju ofron mundësi për përzgjedhje edhe kandidatëve për student me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këtë e realizon përmes hartimit dhe publikimit të kriterëve të veçanta.
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në	Aktet rregullatore të institucionit parashikojnë dhe përcaktojnë kriteret për trajtimin e studentëve me bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme. Strukturat administrative zbatojnë procedurat e hartuara, ngrenë komisione ad hoc vlerësimi dhe

programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	përcjellin propozimet në Bordin e Administrimit për miratim përfundimtar. <i>[Evidenca A.1.3. Rregullore e universitetit Barleti].</i>			
Konkluzione	Procesi nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregullatore institucionale që UniBa ka hartuar e zbaton. Studentët janë në qendër të këtij procesi, i cili bëhet public, është transparent dhe realizohet me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e shumë strukturave dhe njësive që institucioni angazhon.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Aktet rregullatore të institucionit kanë të përcaktuara procedurat e përparimit akademik - mënyrën e shlyerjes së detyrimeve akademike, kalimin nga një vit në tjetrin, mënyrën e përmbylljes së studimeve dhe mundësitë për marrjen e certifikatave apo diplomave në përfundim të studimeve. Fillimisht ato ju bëhen të njohura studentëve gjatë javës së akomodimit që organizon UniBa, ku ju jepet informacion mbi dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre Këto janë të shprehura qartë dhe ju bëhen me dije studentëve më hollësisht dhe në kontakte më të ngushta nga koordinatori e programit, nga sekretaria, nga pedagogët e lëndëve rast pas rasti. <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e studimeve për programin me karakter profesional TOBMSH]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Procedura e njohjes së kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme dhe e transferimit të studimeve nga/ në UniBa është e rregulluar me aktet e brendshme të institucionit. Informacioni ju përcillet studentëve nga zyrat dhe strukturat përkatëse. Edhe në këtë program studimi ka patur raste të transferimit të studimeve (Tabela 21). <i>[Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme per Transferimet 2023]</i>

	<i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e studimeve për programin TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore (syllabuset) janë burimi kryesor i informacionit për studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit, si përfitohet e drejta për të hyrë në provim dhe si zhvillohen provimet, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve, mundësitë e përsëritjes së provimeve, etj. Ky informacion ju përcillet studentëve nga strukturat përkatëse (department, sekretari) dhe nga pedagogët e lëndëve/ moduleve. GVJ pati mundësinë të merrte konfirmimin si nga pedagogët edhe nga studentët e programit për realizimin e këtij komunikimi. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e studimeve për programin TOBMSH]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Plani mesimor i programit të studimit TOBMSH (i ndryshuar në 20%), i bërë public në faqen zyrtare të UniBa përcakton përmbylljen e studimeve nëpërmjet provimit përfundimtar me 6 ECTS. Departamenti ka planifikuar të hartojë programin orientues për provimin e formimit dhe të orientojë studentët për mënyrën e zhvillimit të tij në sezonin e provimeve. Duke qenë viti i parë i aplikimit të kësaj procedure përmbyllëse për programin TOBMSH, janë të kuptueshme paqartësitë lidhur me këtë program orientues dhe detyrim të studentët e vitit të dytë. Besojmë se përvoja e këtij viti akademik do të lehtësojë informimin dhe përgatitjen në kohë për këtë proces. <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Informimi i të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit është në qendër të vëmendjes së institucionit dhe shtrihet gjatë gjithë vitit, por më intensivisht në periudhën kur kandidatët për student pritet të bëjnë zgjedhjen e tyre. Aktivitetet njohëse e promovuese për programet janë të organizuara, me përfshirjen e shumë strukturave dhe punonjësve të institucionit, siç dëshmohet nga dokumentacioni i paraqitur dhe publikimet në faqen zyrtare e në rrjete sociale.
Konkluzione	GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për programin bashkëveprojnë për të informuar studentët dhe për të zbatuar e monitoruar procedurat e përparimit akademik, vlerësimit të dijeve dhe mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	UniBa ndjek disa rrugë për informimin e hollësishëm dhe të qartë të studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, duke filluar me takimet informuese gjatë fazës që kandidatët për studentët kontaktojnë/ kontaktohen nga njësitë e përfshira në këshillimin e karrierës, më pas, kur kanë filluar studimet, në javën e akomodimit kur ju ofrohen informacione të nevojshme për rrugëtimin e tyre akademik në institucion dhe në vazhdimësi gjatë viteve të studimit. Në ndihmë të informimit sa më të plotë dhe të qartë mbi programin e studimit janë përgatitur dhe vënë në dispozicion në hollin e institucionit materiale informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuëse, si: fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe janë përdorur materiale audio-vizive. Edhe rrjeti i gjerë i shërbimeve studentore i organizuar në UniBa jep kontribut në këtë drejtim.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Departamenti, koordinatorja e programit dhe pedagogët e angazhuar në program janë kanalet kryesore të përcjelljes të studentët të informacioneve dhe udhëzuesve për modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. Rregullorja e programit dhe në vecanti syllabuset e lëndëve që ju vihen në dispozicion dhe ju prezantohen studentëve nga pedagogët që në fillim të semestrit kur ato zhvillohen shërbejnë si burimi kryesor informues për njohuritë që do përfitojnë, mundësitë që ju ofrohen dhe detyrimet përkatëse, literaturën dhe format e vlerësimit. <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Strukturat e dedikuara për mbështetjen e studentëve ndërmarrin veprime, organizojnë takime dhe aktivitete për të orientuar dhe mbështetur studentët për punësim. Në UniBa janë ngritur dhe funksionojnë Bordet e Karrierës, ku bëjnë pjesë ekspertë dhe

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	profesionistë të fushës, marrëdhëniet me të cilët mundësojnë afrimin e studentëve me tregun e punës. Zyra e Alumnit dhe Karrierës dhe Dekani i Studentëve luajnë rol thelbësor në këtë proces, sic u konfirmua edhe gjatë vizitës. Mbajtja e kontakteve me të diplomuarit dhe informimi mbi zhvillimin profesional të tyre është gjithashtu një meritë e këtyre strukturave. Pavarësisht angazhimit dhe përpjekjeve institucionale të vlerësueshme, jo të gjithë studentët e programit të diplomuar në vitet e mëparshme janë punësuar në përputhje me diplomën (Tabela 23). Ky fakt mund të nxisë vëzhgime dhe analiza për brezat e ardhshëm të të diplomuarve, me qëllim konsolidimin e programit dhe përmirësimin e imazhit të tij. <i>[Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i studentëve 2023-2024]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabelat përmbledhëse për RVB, Tabela 23]</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët marrin informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, duke filluar që nga java orientuese në fillim të vitit të parë dhe në vijimësi gjatë semestrave. Ky informacion ju përcillet nga koordinatori i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor. Ata informohen për procesin mësimor dhe aktivitete të tjera dhe ju mundësohet pjesëmarrja në kohën e duhur. <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e studimeve për programin me karakter profesional TOBMSH]</i>
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Strukturat përgjegjëse, departamenti, Dekani i Studentëve, përfaqësuesi i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, informojnë studentët për mundësitë e zhvillimit të praktikave, ju përcjellin njoftimet për punësim që sigurohen nga marrëdhëniet e bashkëpunimit të institucionit me partnerë të shumtë nga tregu i punës dhe i orientojnë studentët për karrierën. Studentët e këtij program kanë mundësonë të përfitojnë nga bashkëpunimi i nësive përgjegjëse për programin me njësitë e tjera të Grupit Barleti (Barleti Human Capital etj.) për tu afruar me tregun e punës. <i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i> <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 - 2025]</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka struktura dhe mekanizma për të informuar hollësisht studentët mbi proceset akademike,</i>

	programin e studimit dhe rezultatet e pritshme prej tij, si dhe përdor kapacitetet e veta për të orientuar dhe mbështetur studentët për punësim në tregun vendas.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e “Alumnit dhe Karrierës” UniBa ka krijuar një shabllon të dhënadh dhe ka në dispozicion të dhëna të plota lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik çdo program studimi përfshi edhe në programin e studimit profesional 2-vjeçar “TOBMSH, si dhe për numrin e të diplomuarve në këtë program studimi. Në sekretarinë mësimore na u vunë në dispozicion regjistrat dhe dokumenta të tjera që paraqisnin një bazë të dhënash të plota në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit profesional 2-vjeçar TOBMSH, si edhe për studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë çregjistruar. Informacioni ishte i renditur dhe përmbante detaje për të gjitha elementët e sipër përmendur. Ai korrespondonte me shifrat në Evidencën “Tabela 21”. 2022-2023 5 studente 2023-2024 13 studente <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabelat përmbledhëse për RVB, Tabela 21]</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe	Struktura dhe rregullat e UniBa përcaktojnë detyrimin që plotësohet nga Sekretaria Mësimore lidhur me të dhënat e studentëve. Kjo gjë bëhet nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Njëkohësisht, në funksion të studentëve është portali studentor ² , platformë ku pasqyrohen të

² <https://studentportal.umb.edu.al/>

lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	dhënat mbi notat dhe rezultatet e provimeve, datën e zhvillimit të provimit, etj, Portali studentor u mundëson studentëve të informohen sa herë që ata kanë nevojë lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera që ata kanë nevojë dhe i gjykojnë si të rëndësishme. Sekretaria mësimore përpunon këto të dhëna për Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit sipas kërkesës së bërë prej tyre. <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	UniBa realizon kontroll periodik të njësive përbërëse ku përfshihet edhe sekretaria mësimore, sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj. Çdo student ka dosjen e tij, ku janë të vendosura të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Dosjet e aplikantëve për të filluar studimet verifikohen nga komisioni i ngritur nga Departamenti. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore. Të dhënat e studentëve menaxhohen nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës informatike, të ndërtuar për mbajtjen e lehtë të të dhënave. Gjithashtu në funksion të studentëve është edhe portali studentor, platformë ku gjenden të dhënat mbi notat dhe lëndët e dhëna provim: https://studentportal.umb.edu.al/ <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore]</i>
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti që mbulon degën e studimeve 2 vjeçare TOBMSH në çdo vit akademik harton raportin analitik të këtij program studimi, kur prezantohen të dhëna mbi studentët si cilësia, rezultatet e arritura prej tyre në provime, si dhe për çdo program studimi përfshi edhe TOBMSH bënë krahasimin e objektivave të vendosura me realizimin e tyre. Ky informacion përmbledhet dhe përdoret për të bërë analizën vjetore të institucionit dhe paraqitet në raportin vjetor. Gjithashtu këto të dhëna janë pjesë e analizës vjetore të punës së njësive bazë për ecurinë e programeve të studimit. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën Alumni dhe Karriera ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim. Gjatë visitës na u dhanë shembuj konkret të këtij bashkëpunimi me alumin për programet e tjera dhe në pak raste edhe për TOBMSH sepse janë pak

	studentë që kanë përfunduar këtë program. <i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i> <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025]</i> <i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës 2022-2023]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabelat përmbledhëse për RVB, Tabela 21, 23]</i>			
Konkluzione	GVJ thekson se UniBa ka statistika të rregullta vjetore për studentët nga regjistrimi deri në diplomim, si dhe për elementët e tjerë (largimet apo ardhjet e studentëve) etj. Këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i brendshëm i informacionit ku UNiBa realizon kontrollin periodik të njërive të UniBa (sekretarite mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), Gjithashtu ka të dhëna analitike të detajuara për TOBMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në statutin dhe në Rregulloren e UniBa janë të parashikuara ërfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse dhe përmes këtij angazhimi inkurajohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre për probleme të ndryshme të procesit mësimor dhe të jetës studentore. Nga dokumentacioni dhe nga takimet vumë re se strukturat kryesore të përfshirjes së studentëve janë: • Senati Akademik; • Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta; • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; • Dekanati i Fakultetit; • Këshilli / qeveria studentore; • Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj organizohen të hapura për studentët. <i>[Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti]</i>

	<i>[Evidenca A.1.1.1, Urdhër 360, datë 23.12.2020, Për miratimin e Statutit]</i> <i>[Evidenca A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti]</i> <i>[Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]</i> <i>[Evidenca A.1.33.1, Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre]</i> <i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i> <i>[Evidenca A.1.33.3, Rregullore Qeveria Studentore]</i> <i>[Evidenca A.1.33.4, Strategji e Klubeve Studentore 2020-2025]</i> <i>[Evidenca A.1.33.5, Manual i Klubeve Studentore 2022]</i> <i>[Evidenca A.1.33.6, Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese]</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët të cilët janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të UniBa luajn një rol të rëndësishëm në këto struktura ku ata bëjnë pjesë. Si anëtarë të këtyre organeve, marrin pjesë active në mbledhjet dhe takimet që organizohen dhe mendimet, vërejtjet dhe sygjerimet e tyre janë pjesë e diskutimeve në këto organe. Përmes plotësimit të pyetësorëve që organizohet 2 herë në vit (në fund të çdo semestri) nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mblidhen të dhëna për çdo lëndë dhe pedagog dhe në këtë mënyrë të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me procesin mësimor. Kjo është një mënyrë sesi studentët përfshihen edhe në vlerësimin e procesit akademik. Gjithashtu kjo njësi zhvillon herë pas here fokus grupeve me studentët apo edhe sondazhe të tjera për të mbledhur dhe vlerësuar opinionet e tyre <i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë]</i>. Në UniBa është funksional Këshilli studentor i cili përbëhet nga të gjithë senatorët e grupeve të studimit dhe është organi që përfaqëson zërin e studentëve në vendimmarrje. Përfaqësues nga ky këshill marrin pjesë edhe në mbledhjet e senatit akademik. Njëkohësisht studentët përfaqësohen me një anëtar në grupin e punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programit ku ata bëjnë pjesë, apo në akreditimin institucional. Një student i këtij programi ishte i përfshirë në RVB dhe gjatë vizitës ne e takuam atë së bashku me anëtarët e tjerë të RVB-së
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe

garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve. Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, realizon plotësimin e pyetësorëve 2 javë përpara mbarimit të çdo semestri, pyetësorë që plotësohen në çdo grup mësues, në të gjitha programet e studimit, përfshi edhe TOBMSH, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi me studentët dhe/ose fokus grupet dalin sugjerime për përmirësimin e programit të studimit. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësitë bazë dhe kryesore si edhe nga pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënët. Rezultatet e mbledhura janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllimin e përmirësimit të punës. <i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së]</i> <i>[Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën]</i> <i>[Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në rregulloret e UniBa dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës ne vumë re se mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në TOBMSH është transparente, dhe ka procedura të caktuara për sqarimin e studentëve lidhur me vlerësimin e tyre. Në rast se ka kontestim të vlerësimit, pedagogu ka detyrimin të jap argumentat dhe sqarimet e tij për vlerësimin e studentëve dhe kjo bëhet për çdo lëndë duke organizuar seanca sqaruese mbasi bëhet kërkesa për rivlerësim dhe më vijim bëhet rivlerësimi nga një komision i posaçëm. Kjo është një mënyrë që tregon se UniBa I kushton vëmendje të veçantë transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit <i>[Evidenca A.1.3. Rregullore e universitetit Barleti, Neni 88].</i>			
Konkluzione	<i>Nga puna e bërë GJV thekson se në UniBa realizohet pjesëmarrja aktive e studentëve drejtëpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesve të tyre në organet e ndryshme të UniBa ku theksojmë se kjo pjesëmarrje është reale dhe frutdhënëse Fakulteti dhe departamenti mbështesin përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit TOBMSH duke marrë edhe sugjerimet e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UniBa janë krijuar dhe funksionojnë njësi të posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve. Të tilla janë: Zyra e Pranimi, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatori i Departamentit. Të gjitha këto njësi kanë dokumenta lidhur me procedurat që duhet të ndjekin në punën e përditëshme. Këto njësi janë krijuar me qëllim që të ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore. Nga takimi me studentët ata u shprehën të kënaqur lidhur me punën e këtyre njësive. <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funksionimin e Sekretarisë Mësimore]</i> <i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në të gjitha rastet e nevojshme për të marrë informacion lidhur me ecurinë e tyre mësimore dhe për probleme të tjera që I shqetësojnë studentët e TOBMSH kanë të drejtë t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për të marrë çdo informacion të kërkuar për procesin mësimor, programin e studimit dhe çdo shqetësim tjetër. Gjithashtu ata kanë të drejtë të konsultohen me Dekanin e Studentëve dhe Zyrën e "Alumnit dhe Karrierës", për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda e jashtë UniBa dhe për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore. <i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” Universiteti “Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Në këtë program jep mësim një staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë në mësimdhënie në institucion, që është angazhuar dhe për zhvillimin e praktikës.
2. Institucioni mbështet studentët në të gjithë procesin e shkollimit, që nga hyrja deri në dalje nën kujdesin e stafit të njësive përgjegjëse, Fakultetit, Departamentit dhe koordinatorit të programit, të cilët gjenden gjithmonë pranë studentëve.
3. Institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përdorimit të metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies duke zhvilluar vazhdimisht seminare/trajnime për personelin akademik dhe duke përdorur metoda me në qendër studentin.
4. Lidhjet e këtij programi studimi me programet e tjera të studimit janë relativisht të mira dhe nxisin nivelin e bashkëpunimit midis studentëve dhe pedagogëve.
5. Ka përpjekje të vijueshme për përmirësimin e bërjes së praktikës në bashkëpunim me kompani të ndryshme, kompani gjithnjë e më të mëdha.
6. Përmes investimeve në kampusin e ri, infrastruktura është e përmirësuar dhe plotëson kushte shumë të mira për mësimdhënie dhe për punë laboratorike.
7. UniBa ka një sistem të mirë informacioni & menaxhimi. Ekziston një platformë standarde e-learning.
8. Akses i bibliotekës online. Mbështetja e pedagogëve dhe studentëve në aksesimin e bibliotekës online për mbarëvajtjen e mësimin, praktikës dhe për pedagogët edhe për punën kërkimore shkencore.

Pika të dobëta

1. Megjithëse ka përmirësime të programit të studimit TOBMSH në bazë të vërejtjeve nga vlerësimi i jashtëm i mëparshëm, nevojitet të bëhen përmirësime të mëtejshme të kurrikulës dhe përshtatje me nivelin e programit profesional (Standardi II.4; Standardi III.1; Standardi III.4).
2. Sistemi i brendshëm për menaxhimin e informacionit, për të cilin janë bërë përgatitjet dhe investimet e nevojshme, ende nuk është bërë plotësisht funksional (Standardi III.3; Standardi IV.4).
3. Pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje (dhe plane) të konsiderueshme, për bibliotekën duhet të ketë hapësira më të mëdha fizike dhe më shumë këmbëngulje nga institucioni që studentët dhe pedagogët të punojnë në bibliotekë. Literatura ekzistuese në bibliotekë nuk përdoret në të gjitha rastet në program, ndërkohë që literatura bazë për lëndët e programit në disa raste nuk gjendet në bibliotekë (Standardi II.4; Standardi IV.3).
4. Megjithë angazhimin dhe përkushtimin e një pjese të stafit të institucionit, strukturat përgjegjëse duhet të bëjnë më shumë përpjekje që të paraqesin me saktësi dhe në mënyrë të plotë kapacitetet institucionale (kryesisht ato njerëzore) dhe avantazhet e programit, që vlerësimi i jashtëm ti identifikonte lehtësisht ato. Kjo zbeh disi vlerat e programit në tërësi (Standardi II.3; Standardi III.1).

Rekomandime

1. Përmirësimi i programit të studimit TOBMSH:
 - a. të rishikohen programet lëndore në mënyrë që çështjet e përfshira dhe literatura bazë e paraqitur të mos tejkalojnë objektivat e programit profesional dhe nivelin e të nxënësve të studentëve të këtij programi.



- b. shpërndarja e lëndëve/ moduleve nëpër semestra dhe vite mund të përmirësohet, nëse mbahet parasysh lidhja konceptuale mes tyre dhe rritja graduale e shkallës së vështirësisë së koncepteve dhe aplikimeve që ofrohen gjatë zbatimit të programit.
2. Përmirësime në fondin dhe infrastrukturën e bibliotekës:
 - a. për shtimin e literaturës në bibliotekë, sidomos në tituj të librave fizikë për të mbështetur nevojat e programit TOBMSH dhe për përdorimin e atyre që biblioteka disponon.
 - b. për shtimin e hapësirave fizike që ofron biblioteka UniBa në të ardhmen, për t'i dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë. Gjithashtu sugjerohet shtimi i kompjuterave/laptopëve për t'i shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.
3. Sistemi i brendshëm për menaxhimin e informacionit të bëhet sa më parë funksional, në dobi të punës së strukturave të institucionit (kryesisht sekretarisë) dhe të studentëve për njohjen në kohë reale me informacionet që ju nevojiten gjatë studimeve.
4. Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mundësimi i praktikës në biznese ku studentët e këtij programi mund të përfitojnë realisht në përputhje me pritshmëritë e karrierës së tyre profesionale.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Technician in Business Operations, Marketing and Sales" (TBOMS) provided by the Higher Education Institution "Barleti University"

Strengths and affirmations

1. The TBOMS study program benefits from a qualified and experienced academic staff engaged in teaching activity at the institution. This staff realizes a significant part of the program, including the carry out of practice and internship.
2. The institution supports students in the entire education process, from entry to exit. The staff of the responsible units, the Faculty, the Department, and the program coordinator take care of and are always close to the students.
3. The institution provides special attention to the use of various innovative teaching methods by constantly developing seminars/ trainings for academic staff and using student-centered methods.
4. The connections of this study program with other study programs within the university are relatively good and promote the level of cooperation between students and lecturers.
5. There are continuous efforts to improve the practice in cooperation with different companies, increasingly larger companies.
6. The infrastructure in the new campus has been improved through considerable investments and offers very good conditions for teaching and laboratory work.
7. UniBa has a good information & management system. There is a standard e-learning platform.
8. Online library access. Support for lecturers and students in accessing the online library for the smooth running of teaching, practice, and scientific work for lecturers.

Weaknesses

1. Although there are improvements to the TOBMSH study program based on the suggestions from the previous external evaluation, it is needed further improvements to the curriculum and adaptation to the level of the professional program (Standard II.4; Standard III.1; Standard III. 4).
2. The internal system for information management, for which the necessary preparations and investments have been made, has not yet become fully functional (Standard III.3; Standard IV.4).
3. Despite the fact that the institution has made considerable efforts (and plans), for the library there should be larger physical spaces and more insistence from the institution for students and lecturers to work in the library. The existing literature in the library is not used in all cases in the program, while the basic literature for the program subjects in some cases is not found in the library (Standard II.4; Standard IV.3).
4. Despite the commitment and dedication of part of the institution's staff, the responsible structures should make more efforts to accurately and fully present the institutional capacities (mainly human ones) and the advantages of the program that the external evaluation identified easily them. This somewhat dilutes the values of the program as a whole (Standard II.3; Standard III.1).

Recommendations

1. Improvement of the TBOMS study program:
 - a. revision of the course programs so that the issues included, and the basic literature presented do not exceed the objectives of the professional program and the learning abilities of the students participating in this program.
 - b. the distribution of courses/modules across semesters and years can be improved, through considering the conceptual connection between them and the gradual increase in the degree of difficulty of the concepts and applications offered during the implementation of the program.
2. Improvements in the library fund and infrastructure:
 - a. adding of literature in the library, especially in physical book titles to support the needs of the TBOMS program and for the use of those that the library has.
 - b. for increasing the physical spaces offered by the UniBa library in the future, to enable a larger number of students to access its resources at the same time. The addition of computers/laptops is also suggested to better serve students' navigation in online literature resources.
3. The internal information management system should become functional as soon as possible, to the benefit of the work of the institution's structures (mainly the secretariat) and for students to receive in real-time the information they need during their studies.
 1. Increasing the number of cooperation agreements and enabling to carry out the practice in those businesses where students of this program can really benefit in accordance with the expectations of their professional career.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



